




OSCE
Mission in Kosovo



ZBATIMI I LIGJIT KUNDËR DISKRIMINIMIT

***Sfidë për Kosovën
Qershor, 2007***



ZBATIMI I LIGJIT KUNDËR DISKRIMINIMIT

***Sfidë për Kosovën
Qershor, 2007***

Tabela e Përmbajtjeve

Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit

Habit Hajredini 6

Roli i OJQ-ve në zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit: Përvoja e Bullgarisë

Margarita Ilieva 10

Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës dhe Roli i Ombudspersonit në të

Hilmi Jashari 22

Ligji Kundër Diskriminimit si mase për ndërtimin e besimit në Kosovë

Nuno Luzio 26

Vështrim mbi implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë – Këndvështrimi Serb

Nuno Luzio 26

Përmbledhje Ekzekutive 40

Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit

Raport nga Tryeza e Rrumbullakët e datës 18 prill 2007, Prishtinë/Priština

Remzije Istrefi 42

PARATHËNIE

Prishtinë/Priştina, 26 qershor 2007

Secili proces i parandalimit të konfliktit apo i rehabilitimit pas konfliktit bazohet në strategji të cilat trajtojnë pabarazitë dhe promovojnë mirëkuptimin ndëretnik. Prandaj, është bindje e jona që zbatimi i plotë i Ligjit Kundër Diskriminimit do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në marrëdhënien në mes të komuniteteve të ndryshme dhe do të lehtësojë procesin e pajtimit në Kosovë.

Megjithatë, fushëveprimi i Ligjit Kundër Diskriminimit nuk është i kufizuar vetëm në marrëdhëniet ndëretnike; ai po ashtu ofron edhe kornizë për mbrojtjen e secilit grup. Kështu, ai luan rol kyç në zhvillimin e Kosovës demokratike dhe të përkushtuar ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjes së të gjitha bashkësive.

Kosova mund të jetë krenare që në korrik të vitit 2006 ka miratuar një prej ligjeve më përparimtare të kundër-diskriminimit në Evropë. Kjo është pikë e mirë fillestare që tani duhet të zbatohet plotësisht dhe me sinqeritet.

Në veçanti, gjatë kësaj periudhe sfiduese për Kosovën, zbatimi efektiv i Ligjit Kundër Diskriminimit është pjesë e rëndësishme e përmbushjes së standardeve për të cilat është përkushtuar Kosova.

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Zyra e Kryeministrit kanë theksuar nevojën për një Ligj Kundër Diskriminimit në Kosovë që nga viti 2000. Bashkëpunimi i OSBE-së me institucionet në Kosovë nuk është kufizuar vetëm në hartimin e ligjit. Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me Qeverinë, ka organizuar punëtori dhe ka mbështetur trajnime për bartës të ndryshëm të procesit të përfshirë në zbatimin e këtij ligji.

Zbatimi efektiv i Ligjit Kundër Diskriminimit ka rëndësi jetike për Kosovën. Duke qenë se Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Zyra e Kryeministrit janë plotësisht të vetëdijshme për rëndësinë e tij jetike, ne sërish theksojmë angazhimin tonë të plotë në procesin e vështirë të zbatimit të ligjit, përmes iniciativave si kjo e tanishmja.

Qëllimi i këtij publikimi, i cili gjithashtu paraqet një iniciativë të përbashkët, është të informohet opinioni i gjerë publik mbi rëndësinë e zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit. Artikujt theksojnë rëndësinë e ligjit si bazë e mirë ligjore dhe ofrojnë rekomandime që do të ndihmojnë në përpjekjet e mëdha që kërkohen në zbatimin e tij.

Ambasador Werner Wnendt
Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Agim Çeku
Kryeministër i Kosovës



Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit

Nga Habit Hajredini¹

Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore ka vepruar në Zyrën e Kryeministrit që nga marsi i vitit 2002. Përgjegjësitë, mandati dhe funksionet e saj dalin drejtpërsëdrejti nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 e datës 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe Rregullores së UNMIK-ut 2005/15 e datës 16 mars 2005 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 për Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë.

Mandati dhe përgjegjësitë e zyrës tonë janë:

- (i) mbikëqyrja dhe këshillimi i ministrive në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe çështjeve gjinore.
- (ii) krijimi i politikave dhe nxjerrja e urdhërësive në sferën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe çështjeve gjinore;
- (iii) shqyrtimi i projektregulloreve të hartuara nga dega e ekzekutivit në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi, me praktikatat e qeverisjes së mirë në bashkëpunim me Zyrën për shërbime të ndihmës juridike, si dhe dhënia e këshillave dhe rekomandimeve Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- (iv) shqyrtimi i politikave të veprimit të degës së ekzekutivit, procedurave dhe praktikave të veprimit në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi, me praktikatat e qeverisjes së mirë dhe mundësive të barabarta, si dhe dhënia e këshillave dhe rekomandimeve Kryeministrit dhe ministrive përkatëse sipas nevojës;
- (v) sigurimi i ndihmës në zhvillimin dhe zbatimin e informimit publik dhe projekteve tjera të tilla promovuese me qëllim të nxitjes së vetëdijesimit të popullatës për standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, transparencës në qeverisje, barazisë gjinore, mundësive të barabarta dhe parimeve tjera bazë të qeverisjes demokratike;
- (vi) konsultimi i përfaqësuesve të komunitetit dhe nëse është e nevojshme themelimi i organeve këshillëdhënëse për shqyrtim të qeverisjes së mirë, në fushën e të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe çështjeve gjinore.
- (vii) sigurimi i ndihmës në zhvillimin e politikave në fushën e barazisë gjinore dhe punën e cila ka si pikësynim avancimin e statusit të gruas në bashkëpunim me shoqërinë civile;
- (viii) përcjellja e veprimtarive kundër mashtrimit dhe korrupsionit në degën e ekzekutivit dhe ngritja e vetëdijes kundër mashtrimit;
- (ix) përkrahja e vendimmarrjes demokratike dhe konsultimeve të gjëra brenda Qeverisë;
- (x) inkurajimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje;
- (xi) lëshimi i deklaratave dhe rekomandimeve për Kryeministrin dhe ministrinë përkatëse; dhe
- (xii) shqyrtimi, sipas nevojës, i dokumenteve qeveritare dhe dokumenteve të ndërlidhura me fushën e detyrave dhe përgjegjësi të zyrës, pas dhënies së autorizimit nga Kryeministri.

¹ Kryesuesi i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Te drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore në Zyrën e Kryeministrit.

Prioritetet e Zyrës:

- Promovimi dhe monitorimi i zbatimit të ligjeve brenda mandatit të saj;
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe operacionalizimi i njësive për të drejtat e njeriut në ministritë e Qeverisë;
- Hartimi i strategjisë për të drejtat e njeriut;
- Hartimi i planit të veprimit për të drejtat e fëmijëve;
- Hartimi i strategjisë për integrim të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas;
- Zbatimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe i Planit të Veprimit;
- Zbatimi i Planit të Veprimit për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore; dhe
- Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit.

Zyra për Qeverisje të Mirë gjithashtu shërben edhe si sekretariat për mekanizma të ndryshëm qeveritar siç janë:

- Komisioni Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve;
- Grupi Ndërinstitucional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore; dhe
- Këshilli Kombëtar i Personave me Afësi të Kufizuara.

Ligji Kundër Diskriminimit

Më 30 korrik 2004, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Kundër Diskriminimit, me ndryshime shtesë. PSSP-ja shpalli këtë ligj në gusht të vitit 2004, i cili hyri në fuqi tridhjetë ditë pas miratimit të tij. Miratimi i këtij ligji paraqet një plotësim të bollshëm të rregullimit ligjor në këtë kontekst të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në përputhshmëri me obligimet që dalin nga neni 12, paragrafi 12.3 i Ligjit Kundër Diskriminimit, Qeveria e Kosovës ka filluar dhe ende është në proces të nxjerrjes së akteve nënligjore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Në përputhshmëri me Ligjin Kundër Diskriminimit, gjithashtu janë bërë përpjekje për themelimin e mekanizmave institucionale, të cilat do të vepronin në funksion të zbatimit të ligjeve të miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2006 për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit

Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit u nënshkrua nga Kryeministri në gusht të vitit 2006. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është krijimi i rregullave praktike, lehtësirave strukturore dhe fizike me qëllim të zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit dhe promovimi i trajtimit të barabartë, në mënyrë që të gjithë personat të jenë të lirë nga diskriminimi në baza racore, etnike, gjinore, gjuhësore, arsye të paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, përkatësisë kombëtare, lidhjeve apo bindjeve politike, religjionit apo besimit, pronës dhe formave tjera të diskriminimit.

Plani Gjithëpërfshirës i Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit

Më 11 tetor 2005, gjatë takimit të saj të rregullt, Qeveria e Kosovës miratoi Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Plani Gjithëpërfshirës i Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit, i paraparë që të përmbushet gjatë vitit 2005-2007, përfshinë pesë synime kryesore të cilat do të arrihen përmes veprimtarive të caktuara të ndërmarra nga akterët dhe institucionet përgjegjëse, ashtu siç është paraparë në Planin e Veprimit.

Gjatë vitit 2005 dhe fillimit të vitit 2006, Zyra për Qeverisje të Mirë filloi implementimin e projektit për pro-

movimin e ligjeve kundër diskriminimit, duke prezantuar kështu fazën e parë të përbushjes së Planit të Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Si pjesë e projektit, u organizuan seminare dhe seanca trajnimi (për informata më të hollësishtme, shihni veprimtaritë e dedikuara për trajnime dhe seminare mbi Ligjin Kundër Diskriminimit).

Udhëzimi Administrativ nr. MSHP 2006/05 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrave për Pranimin e Ankesave dhe Kërkesave – Zyra Pritëse

Ministria e Shërbimeve Publike, me qëllim të zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit, nxorri Udhëzimin Administrativ nr. MSHP 2006/05 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrave për Pranimin e Ankesave dhe Kërkesave – Zyra Pritëse. Parashtrimi i ankesave dhe kërkesave është e drejtë themelore e të gjithë personave në Kosovë. Në këtë kontekst, institucionet publike duhet të krijojnë kushte të cilat i mundësojnë çdo qytetari të Kosovës të parashtrijë kërkesë apo të ankohet në lidhje me shërbimet publike.

Ky Udhëzim Administrativ rregullon çështjen e krijimit të zyrave për pranimin e kërkesave dhe ankesave, gjegjësisht zyrave pritëse. Zyrat pritëse janë themeluar në të gjitha institucionet qendrore (Zyrën e Kryeministrit dhe ministri) dhe lokale (të gjitha komunat në Kosovë).

Qëllimi i zyrave pritëse është që t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës që të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me institucionet e Kosovës si sigurorese të shërbimeve publike, si dhe të krijojnë një sistem me të cilin qytetarët mund të ankohen për mungesë të shërbimeve të mjaftueshme publike.

Kodi i Mirësjelljes për Shërbyesit Civil nr. 01/2006

Në maj të vitit 2006, Qeveria e Kosovës miratoi Kodin e Mirësjelljes për Shërbyesit Civil. Kodi i Mirësjelljes për Shërbyesit Civil përmban një sërë parimesh dhe standardesh sipas të cilave do të punojnë të gjithë shërbyesit civil.

Kodi i Mirësjelljes synon krijimin e rregullave të mirësjelljes për shërbyesit civil, mbron statusin e tyre dhe rregullon të drejtat dhe obligimet e tyre në relacion me institucionet dhe qytetarët në përputhshmëri me ligjin në fuqi. Ky Kod do të nxisë cilësi më të mirë si të shërbimeve publike për qytetarët ashtu edhe të etikës së punës dhe interesit të përgjithshëm publik, të cilat karakterizohen përmes integritetit, ndershmërisë, objektivitetit, dhe paanshmërisë në kryerjen e detyrave. Sipas Kodit, shërbyesit civil janë të obliguar të përbushin detyrimet e tyre sipas parimit të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Prandaj, shërbyesit civil duhet të respektojnë dinjitetin dhe barazinë e të gjithë njerëzve pa dallim apo diskriminim.

Promovimi dhe zbatimi i ligjeve

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe parimi i mosdiskriminimit janë elemente përbërëse të institucioneve demokratike. Promovimi dhe mbrojtja e parimit të mundësive të barabarta për të gjithë është e një rëndësie të veçantë.

Sipas legjisllacionit në fuqi (Kornizës Kushtetuese), i cili përmbledhë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Ligjin Kundër Diskriminimit dhe standarde tjera ndërkombëtare, të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit dhe prandaj atyre iu jepen mundësi të barabarta në të gjitha sferat e jetës.

Mirëpo, zbatimi praktik i të lartpërmendurave është çështje tjetër. Koncepti universal i të drejtave të njeriut shpesh nuk përfshinë të drejtat e grupeve të caktuara.

Prandaj, kjo e ka zbuluar nevojën për një përkushtim më të madh drejt promovimit dhe zbatimit praktik,

me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në bazë të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare.

Janë ndërmarrë një numër i veprimtarive si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, me qëllim të zbatimit të legjislacionit dhe parimit të mosdiskriminimit dhe me qëllim të eliminimit dhe zvogëlimit të rasteve të diskriminimit, posaçërisht duke bërë identifikimin e prioriteteve që kanë të bëjnë me obligimet ligjore dhe mandatin.

Në këtë kontekst, prioritet i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, është që të ngrisë kapacitetet e zyrtarëve të lartë në nivelin qendror, si dhe kapacitetet e zyrtarëve të lartë komunal dhe zyrtarëve tjerë komunal, të cilët ose kanë ndikim ose luajnë rol esencial në krijimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut, posaçërisht në krijimin e mundësive të barabarta, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë, si dhe zvogëlimin e rasteve të diskriminimit gjatë ushtrimit të obligimeve të tyre ligjore.

Menjëherë pas shpalljes së Ligjit Kundër Diskriminimit nr. 2004/3 nga PSSP, Zyra për Qeverisje të Mirë ka organizuar një fushatë të informimit publik për promovimin e Ligjit Kundër Diskriminimit me moton si në vijim: "Të gjithë të ndryshëm por të barabartë pranë ligjit". Qëllimi i kësaj ishte që të informojë dhe ngritë njohuritë e opinionit publik për këtë ligj dhe të sigurojë informata për të drejtat të cilat i garanton, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me kundër-diskriminimin. Të gjitha informatat e transmetuara gjatë fushatës janë siguruar në pesë gjuhë: shqip, serbisht, boshnjakisht, turqisht, si dhe në atë rome.

Gjithashtu, në përputhshmëri me obligimet të cilat dalin nga neni 12 paragrafi 12(3) i Ligjit Kundër Diskriminimit dhe me qëllim të lehtësimit të zbatimit të tij, Zyra e Qeverisjes së Mirë ka themeluar një grup punues, i cili ishte përgjegjës për hartimin e Planit Veprues Gjithëpërfshirës për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.

Ky grup punues kishte në përbërjen e vet përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë, OSBE-ja, Zyra e Komisionit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Departamenti i Drejtësisë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe Zyra për Komunitete, Kthim dhe Çështje të Pakicave.

Me qëllim të bërjes së këtij dokumenti më transparent dhe me qëllim të përfshirjes më të gjerë të pjesëmarrësve në procesin e hartimit, më 16 shtator 2005 ZQM/ZKM organizoi një debat publik me qëllim të analizimit dhe marrjes së komenteve nga një spektër më i gjerë i opinionit publik për Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (2005 – 2007).

Më 11 tetor 2005, Qeveria e Kosovës miratoi Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është që të parandalojë dhe luftojë të gjitha format e diskriminimit, të rrisë nivelin e barazisë si dhe të mundësojë trajtim të barabartë pranë ligjit për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ligji Kundër Diskriminimit siguron të drejta dhe obligime për të gjithë personat fizik dhe juridik, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, në fushën e punësimit, pagesave, shkarkimit nga posti, anëtarësimit, dhe përfshirjes në organizatat e punëtorëve, mbrojtjes sociale përfshirë skemat e ndihmës sociale, sigurimit social, shëndetësisë, arsimimit, qasjes në banim dhe forma tjera të pronës (pronë e luajtshme dhe e paluajtshme), qasjes në të mirat materiale dhe shërbimet tjera, qasjes së barabartë pranë institucioneve të drejtësisë dhe çfarëdo të drejte tjetër të garantuar me ligj.

Menjëherë pas shpalljes së këtij ligji nga PSSP, Qeveria e Kosovës, në pajtueshmëri me obligimet e saj që dalin nga neni 12 paragrafi 12(3) i Ligjit Kundër Diskriminimit, filloi nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore me qëllim të zbatimit të dispozitave nga ky Ligj.

Roli i OJQ-ve në zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit: Përvoja e Bullgarisë

Nga Margarita Ilieva²

Mjetet me anë të të cilave OJQ-të mund të ndihmojnë në zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (LKD) janë të shumëllojshme. Mjeti më i rëndësishëm sa u përket ligjeve që janë në interes publik është *procesit gjyqësor strategjik*. Përmes paraqitjes së rasteve të përzgjedhura të diskriminimit para gjykatave ose autoriteteve tjera gjyqësore, OJQ-të mund të bëjnë ndryshime shoqërore përtej rastit të veçantë dhe klientit individual. Efekti që synohet të arrihet përmes proceseve gjyqësore dhe arsyeja pse përdoret është për të ndikuar në problemin më të gjerë shoqëror, të cilin e paraqet rasti individual përmes ndryshimit dobiprurës në ligj ose në politika, dhe rrjedhimisht që u shërben shumë rasteve të ngjashme që janë ekzistuese dhe atyre të mundshme. Këto ndryshime mund të përfshihen në legjisllacion ose në mënyrën se si ai interpretohet dhe zbatohet nga gjykatat ose në praktikën ekzekutive. Më tej, avokimi për ndryshime shoqërore është një mjet i fuqishëm për të ndryshuar qëndrimet publike ndaj barazisë dhe sigurimit të të drejtave për grupet që nuk kanë të drejta të barabarta. Shpesh, rastet strategjike që ndikojnë në vetëdijen e publikut dhe kanë efekt parandalues ose përmirësues në sjelljet zyrtare ose private nuk varen nga rezultati i procesit gjyqësorë – vetë zhvillimi i tij nxitë debat brenda shoqërisë, dhe kjo shpie në zhvillimin e reformave.

Përvoja në Bullgari, pas miratimit të LKD-së ka qenë që proceset gjyqësore strategjike kundër diskriminimit, të sjella përmes përpjekjeve të Komitetit Bullgar të Helsinkit (KBH)³ dhe OJQ-ve të tjera që përfaqësojnë interesin publik, kanë qenë instrumenti i vetëm, më imponues, për të përqendruar vëmendjen e shoqërisë në domosdoshmërinë e zhvillimit dhe të reformimit të diktuar nga ligji i ri. Rastet strategjike kanë vënë në sfidë përjashtimin nga sistemi dhe lënien pas dore të romëve në arsimim, punësim dhe ofrim të shërbimeve, izolimin fizik të personave me aftësi të kufizuara përmes mbylljes së tyre në institucionet e shëndetit mendor dhe ambientin publik i cili nuk ofron qasje për ta, si dhe mospërfilljen dhe mohimin e dinjitetit të barabartë të personave LHBT (lesbik, homoseksual, biseksual dhe transseksual), dhe është shënuar një përparim në lidhje me to. Si rezultat i kësaj, ligji i ri kundër diskriminimit ka hasur në një jetë vibrante menjëherë pas krijimit të tij, dhe që atëherë e tërë shoqëria ka marrë mesazhin se kjo pjesë e legjisllacionit duhet të merret parasysht.

Një formë alternative e proceseve gjyqësore që OJQ-të mund të zgjedhin në kërkim të zbatimit të LKD-së janë *proceset gjyqësore të orientuara në klientë* kundër diskriminimit, qëllimi i vetëm i së cilës është ofrimi i shërbimeve për nevojat e klientëve pa marrë parasysht efektet e mëvonshme. Për shembull, agjencitë juridike dhe organizatat që ofrojnë ndihmë juridike mund të angazhohen në ofrimin e shërbimeve ligjore për klientët e prekur nga diskriminimi me qëllim të sigurimit të qasjes në drejtësi një numri sa më të madh të mundshëm të klientëve vetëm në interes të tyre, pa tentuar që të shkaktohet ndikim për të tjerët.

Të dyja llojet e proceseve gjyqësore mund të përqendrohen në mosdiskriminimin e të drejtave të një grupi të caktuar, për shembull, të femrave ose të serbëve, në një apo të gjitha sferat e jetës publike. Ose, një OJQ mund të angazhohet në trajtimin e rasteve, siç janë qasja në punësim dhe kushte të punës, dhe në mbrojtjen e punëtorëve kundër diskriminimit në këto fusha, pa marrë parasysht identitetin apo bazën sipas të cilës janë diskriminuar si në bazë të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike, religjionit ose moshës. Po ashtu, një opsion tjetër për OJQ-të është vënia në shënjestër e ndonjë shkeljeje të caktuar të mundësive të barabarta, siç janë ndarja në arsimim, ose fjalimi që nxitë urrejtje, ose ngacmimet seksuale dhe të tjera në vendin e punës.

Përveç proceseve gjyqësore, OJQ-të mund të adoptojnë aktivitete të tjera për të ngritur nivelin e zbatimit

² Avokate, konsultante ligjore në Komisionin Bullgar të Helsinkit.

³ www.bghelsinki.org.

të LKD-së, ku përfshihen: hulumtimi dhe monitorimi i praktikave diskriminuese të shoqëruara me dokumentim dhe të përcjella me raportim publik; avokimi për mosdiskriminim në përgjithësi ose për të drejta të barabarta të grupeve të veçanta apo në fusha të veçanta nëpërmjet mediave ose forumeve tjera publike; lobimi pranë organeve të ndryshme për të nxitur reformat e politikave; ngritja e vetëdijes përmes zhvillimit të fushatave, kontaktimi me komunitetin dhe ofrimi i trajnimeve (për avokatët, gjykatësit, aktivistët e OJQ-ve, gazetarët dhe nëpunësit civil). Të gjitha këto aktivitete mund të shfrytëzohen edhe për të plotësuar dhe përkrahur proceset strategjike gjyqësore.

Të gjitha nismat e OJQ-ve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të barabarta, përfshirë këtu edhe proceset gjyqësore, më së miri zhvillohen përmes krijimit të rrjetit dhe shkëmbimit të resurseve me OJQ-të tjera, përfshirë ato ndërkombëtare apo me organizata të tjera, siç janë sindikatat. Në veçanti, sindikatat janë partnerë shumë të rëndësishëm ngase kanë baza masive të anëtarësisë, dhe kjo ua mundëson OJQ-ve për të pasur qasje, përmes tyre, te një numër i madh i individëve me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe fuqizimit të tyre. Një arsye tjetër pse sindikatat janë aleatë të vlefshëm në luftën kundër diskriminimit është ndikimi i tyre te punëdhënësit dhe te qeveria. Gjithashtu, nga perceptimi i publikut, sindikatat janë në gjendje t'i japin më shumë legjitimitet dhe rëndësi kauzës për barazinë. Nëse ato shihen se i kundërshtojnë stereotipat që motivojnë përjashtimet dhe shtypjen, atëherë të gjithë sektorët e shoqërisë mund të ndikohen nga kjo. Sindikatat mund të bëhen bartës shumë të fuqishëm për krijimin e fuqisë punëtore me pjesëtarë të përkatësive të ndryshme. Një mjet tjetër për nxitjen e sindikatave është fakti se në shumë industri, anëtarët e tyre jo vetëm që mund të jenë në pozitë të viktimit të mundshme të diskriminimit, por gjithashtu mund të jenë në pozitë të diskriminuesve, siç janë ofruesit e shërbimeve, mësuesit, personeli mjekësorë, gazetarët etj. Përmes ndërgjegjësimit të tyre për parimet dhe vlerat e barazisë, duke përfshirë këtu edhe rastet e punës për shumëllojshmëri dhe përfshirje, OJQ-të mund të arrijnë shumë në pikëpamjen e parandalimit të diskriminimit. Sfidat me sindikatat mund të jetë se edhe ato vetë mund të jenë ende zhytura në nivele të ndryshme të kulturave që bazohen në paragjykimet diskriminuese dhe mund të ketë nevojë të reformojnë sistemet e tyre të vlerave dhe të praktikave. Në raste të tilla, OJQ-të duhet të investojnë në reformimin e sindikatave përmes përfshirjes së tyre në mënyrë graduale dhe të lehtë në nisma që i ndihmojnë ato për të parë efektin lirues që mund të kenë mundësitë e barabarta në potencialin njerëzor dhe në arritjet personale profesionale, si dhe në ato shoqërore.

Përpjekjet për avokim dhe lobim para autoriteteve vendore gjithashtu mund të maksimizohen duke iu afruar organeve ndërkombëtare që kanë mandat në çështjet e barazisë, për të ndihmuar mobilizimin e presionit të zgjeruar politik mbi qeverinë për të investuar në reforma.

Proceset gjyqësore strategjike

Në fushën e barazisë, si edhe në fusha të tjera të të drejtave të njeriut, proceset gjyqësore strategjike janë një mjet i fuqishëm për të inkurajuar ndryshimet. Ky mjet mund të qartësojë dhe zgjerojë ligjin përmes vënies së praktikave gjyqësore; ai mund të detyrojë qeverinë për ngritjen e logjaridhënies dhe të reformave; mund të edukojë zyrtarët, profesionistët ligjor dhe publikun mbi të drejtat për barazi; mund të vë në pah dhe të dokumentojë padrejtësitë e institucionalizuara; mund të ndryshojë qëndrimet e publikut; dhe mund të fuqizojë të paprivilegjuarët për të vënë në pyetje status-kuonë dhe në fund për të ristrukturuar atë. Veç kësaj, proceset gjyqësore strategjike përforcojnë sundimin e ligjit si mjeti i vetëm valid për të kërkuar dinjitet nga shtypja dhe konflikti shoqëror, krahas mbajtjes së integritetit.

Cilat raste janë strategjike

Strategjike janë ato raste që kanë potencial për të shkaktuar efekte të gjera afatgjate ligjore dhe shoqërore. Ato janë vënë në pah modelet që ndikojnë në një numër individësh në mbarë shoqërinë, ose komunitete të tëra dhe përmes ngritjes së një procesi gjyqësor strategjik për t'u gjykuar, një OJQ e vë nën dritë tërë atë situatë problematike dhe kërkon që ajo të korrigjohet. Në rastet strategjike, gjasat për sukses nuk materializohen gjithmonë. Një proces gjyqësor strategjik i humbur prapëseprapë mund të ngritë vetëdijen

publike dhe transformimin dhe ende ofron rastin për të sjellë efekt juridik nëse dërgohet para një gjykate ndërkombëtare. Gjithashtu, një rast mund të ketë vlerë të shtuar strategjike nëse është i profilit të lartë për nga pikëpamja politike, përveç të qenit ilustrim i një problemi strukturor ose të gjithmbarshëm.

Në Bullgari, një nga rastet më strategjike i ndërmarrë deri më tani sipas LKD-së është padia civile e ngritur nga KBH-ja, së bashku me një koalicion prej më se 70 OJQ-ve të tjera dhe individëve të mirënjohur kundër udhëheqësit të një partie politike dhe anëtarit të parlamentit për shkak të propagandës radikale dhe sistematike ndaj pakicave etnike dhe homoseksualëve. KBH-ja dhe paditësit tjerë kanë dërguar në gjykatë një përzgjedhje të deklaratave më ekstreme anti-rome, anti-turke, anti-semite, anti-myslimane, anti-katolike dhe homofobike të bëra publike nga politikani populist Volen Siderov, duke pretenduar që ato përbëjnë shqetësim për të gjithë popujt pakicë në Bullgari dhe nxitje të diskriminimit kundër tyre. Vetë deklaratat të cilat janë paraqitur si bazë për padinë, kanë qenë mishërim i fushatës masive kundër të gjithë “jobullgarëve”, të cilën vazhdimisht e ka dhënë përmes mediave gjatë disa viteve të kaluara dhe e cila ka mundësuar zgjedhjen e tij në parlament në vitin 2005, të cilin pastaj ka filluar ta shfrytëzojë për përhapjen e mëtutjeshme të porosisë së tij të shfrenuar. Prandaj, ky rast që kishte të bënte me këto deklaratat konkrete ka pasur domethënie më të gjerë përtej vetë rastit, ai ka shërbyer për vënien e tërë platformës politike të Siderovit para llogaridhënies nëpërmjet mjeteve ligjore. Veç kësaj, ka vënë në shënjestër jo vetëm fushatën e urrejtjes të Siderovit, por gjithashtu ka vënë një shembull të qartë të një fjalimi intensiv ksenofobik dhe homofobik që ka shkakuar zemërim në mbarë shoqërinë. Në të vërtetë, ky rast më shumë është drejtuar kundër vetë dukurisë së shprehjes së deklaratave të urrejtjes, se sa kundër individit Volen Siderov. Qëllimi ka qenë që të bëhen përpjekje për të vënë kufijtë e shprehjes së lirë, në rastet kur nëpërkëmbet dinjiteti i të tjerëve dhe nxitet urrejtje dhe keqtrajtim kundër tyre. Mënyra për ta bërë këtë ka qenë përmes mbështetjes në LKD. Pala paditëse ka zgjedhur që të ngritë padinë së bashku me një koalicion prej 70 OJQ-ve të udhëhequra nga KBH-ja, në vend se ta bënte këtë një (grup) person(ash) minoritar, qëllimi ka qenë që të personizohet interesimi i publikut dhe të bëhet me dije mesazhi se fjalimet e urrejtjes jo vetëm që shkelin të drejtat e popujve pakicë, por e dëmtojnë shoqërinë si tërësi. Procesi gjyqësor, gjatë tërë kohëzgjatjes së tij në gjykatë ka pasur mbulim të gjerë nga mediat kombëtare dhe ia ka dalë që të nisë/përkrahë një debat publik përkritazi me ndalimin e fjalimeve të urrejtjes. Kur rasti u fitua, ky ishte një konfirmim për mësimin që publiku dukej se e kishte nxjerrë, duke⁴ se ishte kuptuar - se ka kufij që nuk duhet kaluar në rastet kur shprehen mendimet mbi grupe të ndryshme që e përbëjnë shoqërinë. Ende i mbetet publikut bullgar dhe gjykatave për të përcaktuar saktësisht se ku shtrihet ky kufi.

Një rast strategjik mund gjithashtu të ketë ndikimin të fuqishëm në publik kur ngritet kundër një organi kombëtar publik i cili është përgjegjës për diskriminim të institucionalizuar. Prandaj, KBH-ja ka nisur një proces gjyqësor që ka të bëjë me diskriminimin kundër Prokurorisë së Bullgarisë për të vënë në pah modelin e paragjyqimit të ndezur racist dhe situatën e pafavorshme në sistemin e drejtësisë penale që ndikon negativisht të romët, në rastet kur ata përfshihen si viktime ose kryerës të veprave të pretenduara penale. Bazë e këtij rasti ka qenë një deklaratë eksplicite kundër romëve e bërë nga një prokuror dhe e përfshirë në urdhrin prokurorial i cili u ka dhënë fund hetimeve për një fatkeqësi në të cilën kishte mbetur u vdekur një burrë rom dhe ishte lënduar rëndë nëna dhe vëllai i tij. Viktimat kanë qenë duke mbledhur mbeturina të minierës për një ndërmarrëse që nuk i ka takuar komunitetit rom në kohën kur kishte rrëshqitur dheu dhe i kishte mbuluar nën të. Prokurori e kishte mbyllur procedurën, duke konstatuar se vetë viktime duhej fajësuar për vdekjen të cilën e kishte shkaktuar për shkak të lakmisë së tij të pacivilizuar për të fituar më shumë para duke mbledhur më shumë mbeturina. Në urdhrin e tij, prokurori në mënyrë eksplicite ka identifikuar viktimat si “maxhup” dhe ka vazhduar të portretizojë “këtë popullatë” me shprehje të rënda raciste, duke i karakterizuar ata si jonjerëzor, “të padisiplinuar, të çoroditur, joracional, lakmitar dhe të pacivilizuar”, më vonë, në fjalët e shprehura në aktgjykim, gjykata ka dalë kundër prokurorisë. Gjykata ka konstatuar se ka pasur diskriminim duke u shprehur se ka “qëndrim mospërfillës”, dhe se “po t’i referohej një grupi

⁴ Nuk është zhvilluar ndonjë studim që matë ndikimin e këtij procesi gjyqësor në qëndrimin e publikut ndaj fjalimit të urrejtjes. Konkluzionet më lartë janë vetëm të autorit dhe janë të pasigurta.

tjetër etnik, nuk do të bëheshin përgjithësim të tilla[...] Është etnia e tyre ajo që e ka bërë prokurorin të karakterizojë në këtë mënyrë mentalitetin e pjesëtarëve të këtij komuniteti e në veçanti të viktimitave – paditësin dhe familjen e tij.” Gjykata ka deklaruar se kjo është shkelje e të drejtave të të gjithëve për trajtim të barabartë dhe me respekt dhe për të pasur një mjedis joagresiv. Vendimi ka pasur një mbulim të shkëlqyeshëm në shtypin kombëtar dhe padyshim i ka kontribuar një pamje të përgjithshme publike se LKD-ja po zbatohet në praktikë dhe se gjykatat po e marrin atë seriozisht edhe në rastet kundër institucioneve të fuqishme, siç është prokuroria.

Megjithatë, profili i lartë nuk është kusht që një rast të ketë ndikim strategjik. Një shembull i procesit të gjyqësor strategjik, i cili nuk ka implikime politike, është rasti i ngritur nga një grup për të drejtat e romëve i cili ka vënë në shënjestër një shkollë të veçantë për të vënë në pah dhe për të sfiduar modelin e mbarë kombit të segregimit të në shkollim që i prekë shumicën fëmijëve romë në Bullgari. Shkolla e përzgjedhur ka pasur 100% nxënës romë pa asnjë fëmijë jo-rom. Rasti i ngritur në bazë të LKD-së kundër qeverisë lokale të Sofjes dhe Ministrisë së Arsimit ka kërkuar deklarin gjyqësorë të status-kuosë si formë e ndaluar e diskriminimit për të cilën autoritetet janë përgjegjëse për shkak të dështimit për të përmirësuar situatën. Gjykata është pajtuar me palën paditëse dhe ka deklaruar segregimin racor, dhe kjo ka shërbyer për të dokumentuar me mjete gjyqësore këtë formë të institucionalizuar të diskriminimit e cila ka mbizotëruar me dekada të tëra. Ndonëse vendimi nuk ka imponuar ndonjë masë konkrete gjyqësore, ai është një gurthemel për të nxitur reforma duke e shfrytëzuar atë si paralajmërim për qeverinë. Veç kësaj, pasi që ishte mbuluar nga mediat, rasti gjithashtu ka vetëdijësuar publikun se një situatë e mospërfillur – fëmijët romë që mësojnë ndaras nga të tjerët në shkolla geto – është në fakt shkelje e rëndë e ligjit që shkakton dëme të mëdha afatgjata, pavarësisht nga potenciali i madh për ndryshim qëndrimesh që kjo mund të ketë.

Shembulli i tretë i një rasti strategjik në Bullgari i cili ka përfunduar me zgjidhje të suksesshme, ilustron faktin se ndikimi i procesit gjyqësor nuk kushtëzohet me vendimin e gjykatës, por mund të arrihet thjeshtë përmes ndërmarrjes së veprimit ligjor. Një grup lokal për të drejtat e njeriut në Karlovo - një qytezë e vogël në Bullgarinë qendrore, e ka paditur vetë gjykatën lokale në gjykatë për shkak të mos ndërtimit të pjerërsirave për t’ua mundësuar personave me aftësi të kufizuara në karroca qasjen në ndërtesën e gjykatës. Vëmendja e madhe e mediave lokale dhe e publikut e nxitur nga përpjekjet e një OJQ-je lokale për të bërë fushatë, si dhe mundësitë e mira për të pasur sukses meritore e kanë bërë gjykatën që të kërkojë një marrëveshje për rastin dhe gjykata ka filluar të ndërtojë pjerrësinë para se të përfundonte gjykimi.

Prej nga vijnë rastet strategjike

OJQ-të mund të krijojnë zyra të hapura ose linja kujdestarie, të përhershme ose *ad hoc*, me orar të plotë ose të shkurtuar, për të pranuar dhe përpunuar ankesa për diskriminim dhe i shqyrtojnë ato në mënyrë që të identifikohen rastet strategjike për t’i vazhduar më tej dhe i ndihmojnë klientët tjerë vetëm përmes dhënies së këshillave, ose nuk i ndihmojnë fare. Ato gjithashtu mund të zhvillojnë vizita në terren te komunitetet lokale për të mbledhur raste. Ose, mund të ndërliken me organizatat që ofrojnë ndihmë juridike ose me grupe të komuniteteve dhe u referohen rastet strategjike që u janë dërguar atyre. Po ashtu, OJQ-të mund të ndërliken me sindikata të cilat konsiderohen si burim i rasteve strategjike. Partnerët nga sindikatat mund të shfrytëzohen si pika kontaktuese për ankesat që kanë të bëjnë me diskriminimin, nga të cilat mund të grumbullohen rastet testuese. Po ashtu, resurset e sindikatave mund të përdoren për të hulumtuar dhe dokumentuar faktet relevante, veçanërisht atëherë kur ka modele apo praktika të diskriminimit brenda një ndërmarrje. Përfaqësuesit e sindikatave gjithashtu mund të përdoren për paraqitjen e fakteve para gjykatës. Ata mund të paraqiten si dëshmitarë shumë bindës për shkak të legjitimitetit dhe autoritetit të fituar në shoqëri nga organizatat e tyre. Edhe gazetarët mund të njoftohen se një OJQ është në ndjekje të një rasti të caktuar dhe të luten që të përcjellin informatat për çfarëdo rasti të tillë që mund të zbulojnë.

Rastet strategjike, gjithashtu mund të rrjedhin nga monitorimi i zhvilluar nga OJQ-të, si një aktivitet i ndarë dhe i pavarur që kontribuon në zbatimin e barazisë. Monitorimi, i cili ua mundëson OJQ-ve grumbullimin e të dhënave relevante dhe identifikimin e problemeve më serioze nga pikëpamja e rëndësisë dhe përma-

save të diskriminimit, është gjithashtu një mjet që identifikon rastet që kanë ndikim.

Monitorimi, në format e tij më të specializuara, siç është testimi i situatës, mund të sigurojë në burim të fuqishëm të rasteve strategjike të sajuaara përmes aktiviteteve tona vetanake për të përshtatur sa më mirë qëllimet tona strategjike. Kështu, në vend se të përdoret një rast i gatshëm që na referohet, i cili mund të mos jetë ideal nga pikëpamja e modelit faktik, provave në dispozicion, personalitetit të klientit apo gjendjes personale, kohën ose vendin e atij fakti, ose hapat procedural tanimë të ndërmarrë ose që nuk janë ndërmarrë, mund të përdorim testimin apo metoda të tjera të monitorimit për të ndërtuar vetë rastin tonë, ku do të kontrollojmë punën tonë dhe karakteristikat e saj për të maksimizuar mundësitë për sukses. Prandaj, udhëheqësi i procesit gjyqësor strategjik, mund të përdorë testimin i cili është një mjet për të dokumentuar dhe siguruar prova për të përshtatur, për shembull, një rast strategjik të diskriminimit.

Shembull: Një OJQ merr dëshmi në bazë të thashethemeve për një praktikë nga personeli i sigurimit të gjykatave në qytete të ndryshme për moslejimin e pjesëtarëve të popullatës romë për të hyrë në ndërtesën e gjykatës, përveç nëse janë të shoqëruar nga avokati ose nëse paraqesin ftesën e shkruar si dëshmi që ata duhet të marrin pjesë në seancë dëgjimore si palë ose si dëshmitarë. Në anën tjetër, çdo pjesëtarë tjetër i publikut lejohet të hyjë lirshëm pas paraqitjes së një dokumenti të identifikimit. OJQ-ja pastaj e dërgon një ekip testuesish të përbërë nga individë romë dhe jo-romë për të provuar këtë praktikë, duke vizituar një përzgjedhje të ndërtesave të gjykatave dhe duke tentuar për të hyrë. Testuesit kontrollojnë rrobat dhe dukjen e tyre në përgjithshme, si dhe sjelljet e tyre, në mënyrë që të jenë sa më të ngjashëm, për të fshehur dallimin etnik. Po ashtu, ata shmangin me ngulm dhe në çdo mënyrë provokimin e zyrtarëve për t'ua hequr çfarëdo arsye për ndalim të hyrjes, siç janë, për shembull, sjelljet e pahijshme ose bartja e ushqimit. Pastaj, të gjithë testuesit e vëzhgojnë mënyrën se si trajtohen romët në krahasim me jo-romët dhe vërtetojnë çfarëdo refuzimi të hyrjes së romëve, krahas lejit të hyrjes për jo-romët. Pasi të kryhet testimi dhe pasi ekipi të dokumentojë refuzimet në kontestin krahasues me dëshmitë e dëshmitarëve dhe në këtë mënyrë sigurimin e provave që do të përdoren para gjykatës dhe pasi të ketë në dispozicion paditës në emër të të cilëve mund të ndërmerret veprimi ligjor, OJQ-ja pastaj mund të përzgjedhë të gjitha refuzimet e dokumentuara dhe një sërë rrethanash që mund të shfrytëzohen më së miri si bazë për rastin, përfshirë aspektet e juridiksionit dhe pastaj hapet një forum për këtë. Jo më pak e rëndësishme, paditësi i ardhshëm do të jetë anëtar i ekipit të OJQ-së kështu që ka qëllim strategjik, siç mund ta ketë edhe një klient i vërtetë dhe do të jetë i besueshëm në pandryshueshmërinë e deklaratës së tij, kjo mund të mos ndodhë me klientët e vërtetë. Paditësi ka gjasa që të jetë më i artikuluar, i prezentueshëm, i arsimuar dhe këto e bëjnë atë shumë të përshtatshëm për ta paraqitur rastin para mediave në avokimin rreth procesit gjyqësor dhe të nxisë mirëkuptimin dhe përkrahjen. Dëshmitari testues, po ashtu, ka gjasa të bëjë një punë më të mirë se sa shumë dëshmitarë të abuzimeve me të drejtat e njeriut në jetën e përditshme, të cilët si edhe viktimat, mund të kenë prirje të jenë të përjashtuar nga shoqëria dhe më pak imponues se një profesionist i aftë i OJQ-së, i cili, gjithashtu do të jetë i besueshëm se do të jetë i pranishëm përgjatë tërë viteve të zhvillimit të procesit gjyqësor.

Në Bullgari, KBH-ja dhe grupe të tjera të të drejtave të njeriut kanë shfrytëzuar gjerësisht metodën e testimit për të dokumentuar dhe dëshmuar diskriminimin kundër pakicave. Janë zhvilluar teste për të zbuluar dhe regjistruar përjashtimin e romëve nga qasja në punësim dhe në shërbimet publike, siç janë hotelet, restorantet, kafenet apo pishinat. Një sërë rastesh të diskriminimit janë ngritur para gjykatës dhe janë fituar në bazë të dëshmimeve të testuesve. Testimi i rasteve të qasjes në punësim ka ndjekur këtë skenar: një testues rom i angazhuar nga OJQ-ja i telefonon punëdhënësit në përgjigje të një shpallje për vendi të lirë të punës të publikuar në gazetë. Testuesi ka kualifikimet e nevojshme që kërkohen në shpallje dhe përzgjidhet në atë mënyrë që të jetë i identifikueshëm si rom për nga dukja e tij. Ai/ajo pyet për procedurën për aplikim për punë dhe pastaj ftohet në intervistë. Kur ai/ajo paraqitet, atij/asaj i thuhet se vendi i punës tanimë është zënë ose përdoret një pretekst për ta larguar. Apo i thuhet se nuk mund të pranohet sepse nuk pranohen romët. Pas kësaj, një testues jo-rom kalon përmes të njëjtit proces, por ndryshe nga kandidati rom, ai pranohet në intervistë apo, në disa raste, ftohet menjëherë në punë. Në raste ekstreme,

personi që lajmërohet në thirrjen e parë telefonike në mënyrë eksplicite thotë se romët nuk duhet të aplikojnë, pasi që nuk kanë gjasa për t'u punësuar. Pas kësaj, në gjykatë, testuesi jo-rom do të dëshmonte si dëshmitar ndërsa testuesi rom do të paraqitet si paditës. Në rastet kur deklarata nga punëdhënësi është eksplicite se romët, në parim, përjashtohen si aplikantë për punë, që tregon një praktikë që ndikon ndonjë apo të gjithë romët, KBH-ja dhe grupe të tjera kanë ndërmarrë veprime ligjore në emër të tyre, duke e shfrytëzuar këtë mundësi që parashihet me LKD-në e Bullgarisë për interesin publik, kështu OJQ-të, jo vetëm që përfaqësojnë viktimat që e japin pëlqimin për këtë, por gjithashtu iniciojnë procedura në cilësi të palës, në rastet kur barazia e të drejtave të shumë individëve preket nga një veprim apo praktikë e caktuar, pa pasur nevojë për autorizim të personave të prekur. Një qasje e ngjashme është ndjekur në proceset gjyqësore që ka vënë në shënjestër refuzimet anti-rome për të pasur qasje në vendet ose shërbimet publike. KBH-ja po ashtu ka përdorur testimin për të provuar praktikat e legjitimitit nga policia për të vënë në pah ndonjë profil racor që nëpërkëmbë emigrantët me prejardhje nga Afrika dhe Azia.

Gjithashtu, KBH-ja ka shfrytëzuar programin e saj për ankesa mbi të drejtat e njeriut, si dhe monitorimet klasike të modeleve të përgjithshme shoqërore dhe në veçanti të institucioneve të mbyllura, për të kërkuar raste testuese. Shumë nga rastet tona në mbrojtje të klientëve me aftësi të kufizuara mendore rrjedhin nga programet tona monitoruese, ndërsa zyrat tona që merren me ankesat kanë qenë burim i rasteve të diskriminimit kundër pakicave fetare, grave dhe pakicave kombëtare. Po ashtu, vazhdimisht na janë përcjellë raste nga aktivistë të komuniteteve lokale, shumë nga të cilat janë bërë strategjike, bile edhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç janë, ndër të tjera, rasti i *Nachova kundër Bullgarisë*, vendimi i parë nga Gjykata që konstaton diskriminim racor në Evropë.

Llojet e angazhimit të OJQ-ve në proceset gjyqësore strategjike

OJQ-të mund të përkrahin viktimat individuale të diskriminimit duke i ngritur rastet e tyre në gjykatë përmes sigurimit të përfaqësimit ligjor. Apo, vetë OJQ-ja mund të ngritë rastin në emër të viktimës, me autorizim të kësaj të fundit. Gjithashtu, nëse statutet apo praktikat gjyqësore e mundësojnë këtë, grupet e interesit publik mund të iniciojnë procedura në cilësi të palës, me kusht që ato mund të vërtetojnë se është prekur interesi publik në një rast konkret. Në rastet kur rregullat standarde nuk janë shprehimisht liberale për grupet e interesit publik në ngritjen e proceseve gjyqësore *actio popularis*, një strategji për iniciuesit e proceseve strategjike të OJQ-ve mund të jetë iniciimi i proceseve gjyqësore me ndikim, të pikësynuara në mënyrë specifike në liberalizimin e jurisprudencës për kërkimin e konstruksioneve standarde, funksionale gjyqësore që mundësojnë rregulla të shkruara, të orientuara kah interesi publik, që do t'ua mundësonin OJQ-ve të ndërmarrin veprime ligjore në interes publik dhe kundër diskriminimit.

Ndryshe, OJQ-të mund t'i bashkëngjiten procedurave të nisura nga individët ose OJQ-të tjera të interesuara, ose *miqtë e gjyqit*, dhe të paraqesin të gjeturat në lidhje me çështjet specifike, duke i siguruar gjykatës standardet ndërkombëtare dhe krahasuese dhe precedentët gjyqësore, në mënyrë që t'iu ndihmojë gjykatave që të nxjerrin vendime kompetente. Disa nga rekuizitat e kësaj çështjeje janë se intervenimi i palës së tretë është më pak e kushtueshme si në kohë, ashtu edhe në resurset njerëzore dhe financiare, (nuk ka tarifa gjyqësore, nuk ka rrezik për urdhëresë për të paguar harxhimet e palës tjetër, nuk ka harxhime që kanë të bëjnë me dëshmi). Qasja në procedura gjyqësore mund të jetë më e lehtë si miq të gjyqit, se sa si parashtrues i ankesës, pasi që rregullat për miqtë e gjyqit mund të konsiderohen të jenë më liberale, shkallë të ulët për rekuizita të interesit ligjor. Kundruall palëve në procedurë gjyqësore, një *mik* gjykatës nuk është i obliguar me *res iudicata* të aktgjykimit, dhe mund ta përsëris prapë çështjen. Veç kësaj, një *mik* nuk i detyrohet çështjes së rastit siç formulohet nga palët, dhe mundet të paraqes dëshmi shtesë në gjykatë si dhe çështje shtesë ligjore. Dhe është me rëndësi, një *mik* nuk ka klient tjetër përveç qëllimit strategjik, dhe është i lirë nga të gjitha obligimet e marrëdhënieve klient-avokat. Nga aspekti negativ, një *mik* nuk mund të ketë kontroll në procedura ashtu siç e ka klienti, dhe nuk është i përfshirë në kontributin e prezantimit të dëshmimeve. Një *mik*, jo sikur edhe palët, nuk përfiton prej thirrjes në seancë

⁵ Kjo letër ilustruese, e përpiluar nga QEDR, mund të merret lirisht nga autori sipas kërkesës.

dëgjimore në gjykatë, dhe nuk ka të drejtë për t'i mbuluar harxhimet dhe shpenzimet, edhe në rast se aktgjykimi është i favorshëm.

Edhe nëse ligji shprehimisht nuk ofron mundësi për intervenim të OJQ-së në procedura si *miq*, OJQ-të në mënyrë pro-aktive mund të kërkojnë një gjë të tillë në baza të parimeve të përgjithshme ligjore, dhe si kuptim të përbashkët të argumenteve. Në rastin më të rëndë, kur ata dështojnë të jenë të pranuar formalisht nga pala në procedurë, ata ende mundën që nëpërmjet njëres palë ta bëjnë një gjë të tillë në mënyrë jo formale për procesverbal gjyqësor. Të bashkuar në procedurat gjyqësore kundër diskriminimit si *miq*, formalisht, dhe jo formalisht, është taktikë e avokatëve të Gjykatës së Lartë të Bullgarisë që janë të punësuar nëpër gjykatat e Bullgarisë, dhe në mënyrë të suksesshme është bërë përfshirja e OJQ-ve ndërkombëtare, siç është Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR). Kemi prezantuar vazhdimisht nëpër gjykata materiale ligjore ndërkombëtare dhe krahasuese për parimet dhe për ngarkesat, si dhe zbatimin në praktikë.⁵

Një mundësi tjetër e procedurës së barabartë ligjore është nisma e procedurave që kanë për qëllim kryesor interpretimin e rregullave nga gjykatat kushtetuese ose supreme, siç parashihet me rregullat e zbatueshme procedurale. Dhe ngjashëm si intervenimi i palës së tretë, një procedurë e tillë gjyqësore është më pak e kushtueshme sa i përket kohës dhe resurseve, pasi nuk merren me çështjet faktike, dhe nuk ka procedura kundërshtuese.

Lloji tjetër i procedurës së barabartë gjyqësore, njëri i cili mund të jetë i ndikuar shumë, janë veprimet e ngjashme, ku një numër i konsiderueshëm dhe i papërcaktuar i individëve që ndikohen ngjashëm me një akt të veçantë, ose nga ndonjë praktikë të diskriminimit që është të bashkuar në një veprim të përbashkët ligjor kundër palës përgjegjëse.⁶ Kjo mund të ketë ndikim të madh në subjektet private dhe autoritetet publike, të cilët ballafaqohen me shuma të mëdha të kompensimeve për parashtuesit e ankesave. Veç kësaj, ky lloji i procedurës gjyqësore kursen shumë harxhime dhe i sforcon viktimat individuale sepse iu lejon që të përfitojnë nga prezantimi i fakteve për herë të parë, argumentet e meritës, dhe forcimi i procedurave në rast se borxhliu nuk përmbush obligimin sipas aktgjykimit. Dhe e fundit, por jo edhe më pak e rëndësishme, veprimet cilësore ngritin vëmendjen e publikut, e ngritin vetëdijen, edukimin, dhe i forcojnë njerëzit kundër diskriminimit, si dhe në të njëjtën kohë ka efekt parandalues.

Kur është iniciuar rasti i sipërpërmendur *Siderov* në Bullgari, GJLB është munduar të këtë pikërisht këtë lloj të cilësisë, apo veprimi kolektiv. Siç është vërejtur, ankesa është parashtuar në mënyrë të përbashkët nga më se 70 OJQ, si dhe 20 individë që i përkisnin minoritetëve të ndryshme. Sidoqoftë, përderisa ky masivitet në veprim kishte prodhuar efekt të vazhdueshëm në publik, nuk kishte pasur sukses në anën ligjore. Gjyqtari i cili ishte caktuar për këtë rast të përbashkët kishte vendosur që, duke shfrytëzuar lirinë e veprimit sipas ligjit mbi procedura, të ndaj sipas identifikimit të parashtuesve të ankesave në tetë procedura të ndryshme, që secili entitet individualisht të merret në pyetje nga një gjyqtar tjetër. Kështu, 68 OJQ ishin futur në një rast, popullata romë në një rast tjetër, çifutët në një rast tjetër, dhe maqedonasit, turqit, armeninët, vlahët, homoseksualët dhe lezbiket në rast tjetër. Dhe si rezultat ne ishte dashur të punojmë tetë herë më shumë se sa ta kishim të kishim punuar vetëm në një rast të thjeshtë të parashtimit të ankesës-duke dëshmuar të njëjtat fakte tetë herë për gjyqtarë të ndryshëm, duke plotësuar tetë herë shkresat e ndryshme. Nga ana pozitive, kjo ka pasur ndikim në zgjerimin e rrezikut të humbjes së një rasti të tillë. Edhe nëse do të humbin një apo dy raste të ndara, ne ende do të kishim mundësi të fitonim së paku njërin nga tetë rastet, duke përmbushur ndikimin në publik. Një gjë e tillë mund të jetë kundër produktive. Në fund të ditës, publiku do të ketë përgjigje të ndryshme, kundërshtuese për këtë çështje-a është e lejuar që gojarisht të ofendohen minoritetet në publik-apo nuk është. Nuk do të ishte sjellje e mirë

⁶ Termi *veprim cilësor* është përdorur këtu si kuptim më i gjerë se sa veprimi cilësor klasor siç përdoret në ShBA. Ka kuptim që të tregoj në përgjithësi llojet e procedurave gjyqësore që përfshinë një numër më të madh të individëve ose entiteteve, që vepron në një palë.

nëse do të krijohet standard koherent për të gjithë që të mësohen që ta mbështesin atë.

Kjo shërben për të ilustruar disa nga rreziqet që disa OJQ ambicioze bëjnë parashtrimin e ankesave për procedurë gjyqësore, si dhe disa kufizime që bëjnë në mjedis. Rregullat mund t'iu mundësojnë gjyqtarëve që të kenë liri të veprimit, që mund ta shfrytëzojnë këtë për t'u tërhequr interesin publikut në favor të tyre, apo arsyetime të cekëta, siç mund të jetë shmangia e prezumimit të përgjegjësise për çështjet e ndërlikuara, të rënda, politike apo kontroverse.

Taktikat për zmadhuar ndikimet strategjike të rastit

Është e nevojshme të thuhet se, të gjitha praktikatat konkrete të strategjisë për zmadhim në praktikë do të varen nga specifikat e konteksti politik dhe ligjor. Për shembull, mund të merren parasysh disa çështje pragmatike që mund të jenë të vlefshme në kontekst. Për shembull, zgjedhja e fakteve të mirëfillta (e cila qartëson fuqimisht çështjen e synuar dhe ka potencial bindës); që ka baza të mirëfillta ligjore (më e përshtatshme për të paraqitur natyrën e shkeljes, dhe më autoritative); mjetet e mirëfillta juridike për zmadhimin e ndikimit; procedurat e mirëfillta për t'u përdorur (siç janë përfaqësimi, ose parashtrimi i ankesës ose miqtë e gjykatës, etj); dëshmia e mirëfilltë (duke përfshirë këtu jo vetëm dëshminë në dispozicion, por edhe ato që duhet të grumbullohen, dhe statistikat); dhe aktorin e mirëfilltë që duhet të angazhohet në procesin gjyqësor (si të jetë ai si parashtrues i ankesës, ose të jetë në kapacitet tjetër-klient me personalitetin e cili është në gjendje të provokojë publikun dhe kuptimin dhe solidaritetin gjyqësor, dhe gjithashtu dikush që është i besueshëm dhe i palëkundur, i cili do të zgjedh procesin gjyqësor; apo edhe ndonjë OJQ e respektuar mirë dhe që ka ndikim).

Një pikë tjetër e rëndësishme dhe e ndërlikuar që duhet të merret parasysh kur të vendoset në emër të kujt duhet të silltet rasti është potenciali për kundër-produktivitet nëse lënda identifikohet me dikë që shihet si kontrovers, apo partizan. Kjo është në veçanti e vlefshme kur çështja e sfiduar nëpërmjet rastit shihet si kontroverse. Andaj, kur është bërë përgatitja e rastit të profilit të lart të folurit me urrejtje rasti *Siderov*, në Gjykatën e Lartë të Bullgarisë (GJLB) e kemi konsideruar atë si më shumë të përshtatshëm për të promovuar publikisht rastin si rast të paraqitur nga koalicioni i shoqërisë civile të OJQ-ve të cilat nuk janë kundërtënëse, siç janë grupet për mbrojtjen e fëmijëve, OJQ-të e personave me aftësi të kufizuara, grupet për lirinë e të shprehurit, grupet për mbrojtjen e ambientit, OJQ-të e grave dhe të tjerat të ngjashme që shihen si të pranueshme, më shumë se sa një veprim të GJLB si një grup politik për të drejtat e njeriut që shihet nga shumica si partiake kur merret me çështjet e minoritave, në veçanti, romët, të cilët janë objekt i urrejtjes në tërë shoqërinë bullgare. Në frikohemi se rasti mund të shihet si vepër partiake nga "Mbrojtësit e ciganëve", pa ndonjë rëndësi për shoqërinë si tërësi. Në të kundërtën, nëse shoqatat profesionale dhe OJQ-të për të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara pretendojnë se kjo është pozita e tyre, atëherë porosia do të ishte se shoqëria civile e kundërshton të folurit me urrejtje e cila iu drejtohet të tjerëve pa qenë personalisht e ndikuar, kështu, një e folur e tillë është e dëmshme për të gjithë, si dhe është e gabueshme në parim. Për ta bërë procesin gjyqësor më autoritativ dhe më legjitim, neve kemi pasur personalitete publike, siç janë akademikët, shkrimtarët, shkencëtarët politik dhe gjyqtarët e mëparshëm kushtetues që janë paraqitur publikisht duke dhënë konferenca për shtyp dhe intervista pasuese. E tërë kjo kishte kontribuar në perceptimin pozitiv të rastit nga shumica në shoqëri.

Një pikë tjetër e logjikës së njëjtë është se OJQ-të në mënyrë specifike mund të ndjekin çështje tjera që janë më të pranueshme për gjyqësinë/publikun në mënyrë që, nëpërmjet tyre të fitojnë besueshmëri, si për vete, ashtu edhe barazinë në përgjithësi, dhe me qëllim që të transferohet prej një besueshmërie në tjetrën, tema më kontroverse të diskriminimit. Për shembull, një gjyqtar për diskriminim, qëllimisht mund të marr rastet e diskriminimit në baza të moshës dhe në baza gjinore, që më shumë duket se mbështeten, në mënyrë që të kultivojë mirëkuptimin e autoriteteve/publikut, të cilin më vonë e përdorë për rastet e diskriminimit racor, që mund të jenë më kundërtënëse.

Gjithashtu, do të ishte e dobishme të fillohej me raste më të thjeshta të diskriminimit të tërthortë për të

cilat ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme, që do të lehtësonin rrugën për rastet më të vështira. Edhe nëse këto raste janë të qarta sa i përket dëshmisë, është mirë të paraqitet parimi i ndërrimit të barrës së provës nga argumentet njëërës palë, duke i edukuar gjyqtarët për këtë në mënyrë që ata të mësohen me këtë dhe dalëngadalë ta pranojnë atë, pa qenë në presion për ta zbatuar atë menjëherë. Andaj, kur të vjen koha më vonë për ta futur këtë parim në efekt në rastet e vështira që nuk mund të fitohet, derisa të ndërrohet barra e provës, gjyqtarët do të jenë më të përgatitur, dhe më pak do të kenë rezerva për ta bërë këtë.

Sa i përket zgjedhjes së argumenteve ligjore, është e dobishme që të rikujtohen gjyqtarët për detyrat e tyre për të interpretuar ligjin e brendshëm në atë mënyrë që të jetë në përputhje me ligjin ndërkombëtar, përfshirë të drejtën zakonore ndërkombëtare (e cila është obligative për të gjitha shtetet pa marr parasysh ratifikimet), duke u mbështetur në supozimin se Parlamenti ka menduar se ligji të jetë në përputhje me ligjin kushtetues dhe ndërkombëtar, që nuk kundërshtohet asnjëri lehtë. Ky obligim gjyqësor del nga neni 27 Konventës së Vjenës për Ligjin e udjive i cili i obligon gjykatat, si dhe autoritetet tjera shtetërore, që t'i bëjnë më efikase obligimet ndërkombëtare të shtetit pa marr parasysh përmbajtjes së ligjit vendor. Duke argumentuar se ligjet vendore duhet të shpjegohen në atë mënyrë që t'i epin efekt të drejtës ndërkombëtare, ne kërkojmë që të lexojmë ligjet ndërkombëtare nëpërmjet statuseve të mangëta vendore që kërkojnë me detyrat shtetërore, që gjithashtu i obligojnë gjykatat që t'i epin efekt të plotë obligimeve të tyre ndërkombëtare. Ne mbështetemi në rregullin se shteti mundet që mos të thirret në ligjet e brendshme për të arsyetuar mos dhënien e efektit udjive ndërkombëtare.

Është e dobishme të përmendet, si çështje e temës, epërsinë e ligjit ndërkombëtar dhe kushtetues mbi ligjet tjera, dhe të kërkohet nga gjykatat që të injorojnë ligjet diskriminuese kundërthënëse në mënyrë që të zbatohen normat e barazisë superiore.

Argumentet tjera të dobishme për zgjerimin e mbrojtjes së barazisë së drejtave është që të mbështeten në parimin e mbrojtjes praktike dhe efikase në mënyrë që të parandalohen të drejtat të jenë teorike dhe abstrakte; në qëllimet e thelbësore dhe vlerat e ligjit si bazë për interpretime të zgjeruara dhe të qëllimshme; në parimin se ligji i barabartë duhet të jetë "instrument i gjallë" për t'u interpretuar në kursin e ngritjes së kushteve sociale; në detyrat e shpjeguara pozitivisht; në analogjitë ligjore dhe faktike me të drejtat tjera të krijuara për të siguruar mjetet juridike; në supozime dhe konkluzione; në të drejtën e precedentit. Kur të përpilohet materiali krahasues, është e dobishme të merret parasysh kultura vendore ligjore, dhe perceptimi i gjyqtarëve, ose në të kundërtën, mospërfillja e juridiksioneve të huaja. Një anim i tillë gjyqësor, për shembull mund të burojë nga mos përputhshmëria doktrine ndërmjet normave të së drejtës zakonore dhe së drejtës së precedentit, dhe së drejtës kontinentale. Për ta bindur një gjyqtar të Evropës Lindore që e percepton veten si kontinental për ta shikuar shembullin e një kolegu irlandez, mund të jetë pragmatike referimi në analogji ndërmjet koncepteve të dy sistemeve, dhe të përdoret terminologjia kontinentale për të caktuar institucionet e së drejtës zakonore për të ndihmuar perceptimin e tyre nga gjyqtarët vendor. Ndërtimi i argumenteve për ligjin krahasues mund të jetë i vlefshëm për tu mbështetur "konsensusin e përbashkët" ndërkombëtar/rajonar për disa çështje për barazi.

Sa i përket fushatës së përkrahjes së procedurës strategjike gjyqësore, mbështetja e mediave është vitale. Si pasojë e pasjes së qëllimit ndërrimit shoqëror, siç është arsimit publik dhe ngritja e vëmendjes, fuqizimi dhe mobilizimi, të folurit publik që bënë shpjegimin dhe promovimin e procesit gjyqësor bëhet i domosdoshëm për të pasur efekt. Me formimin e koalicioneve të OJQ-ve vendore për ndihmë të përbashkët, si dhe për procese gjyqësore, mund të jetë shumë e dobishme, siç është e paraqitur edhe në përvojën bullgare në rastin *Siderov*.

Rreziku i procesit strategjik gjyqësor

Procesi strategjik gjyqësor nganjëherë do të jetë i rrezikshëm dhe kundër produktiv për interesat e atyre që janë të ndikuar nga rezultati i procesit. Për shembull, një procedim i iniciuar nga agjenda e interesit publik të një OJQ-je për sfidimin e ndërhyrjes së bordit të shkollës në vendimin e një vajze myslimane për

të bartur shaminë në shkollë, nëse do të jetë e pasuksesshme, mund të rezultojë me ndikim zyrtar me shkallë më të gjerë në të gjitha vajzat që bartin shami në shkolla, kështu paraqesin dëm mbi individët e rrezikuar, më shumë se sa përmirësimin e situatës së përgjithshme të barazisë.

Një OJQ duhet të merr në konsideratë gjithashtu edhe faktet se një procedim mund të jetë produktiv ose kundër produktiv, jo vetëm nëse fitohet, por thjesht nëse procedimi vihet para gjyqit. Për shembull, paraqitja e një procedure gjyqësore për të shprehurit me gjuhën e urrejtjes ndaj një politikani popullariteti i të cilit është në ngritje, edhe nëse fitohet procesi më vonë, mundet që politikisht të bëjë dëm në barazinë dhe dinjitetin, për shkak se perceptimi i publikut për atë politikanin i cili viktimizohet për shkak të lirisë së tij të shprehjes mund ta bëjë atë edhe më të popullarizuar dhe të pa ndëshkueshëm.

Aktivitetet tjera të OJQ-ve për shtyrjen përpara të barazisë

Përveç trajnimeve dhe ndarjes së informatave, në përvojën e GJLB, në Bullgari janë identifikuar idetë si në vijim dhe që kanë qenë të dobishme për OJQ-të për të bindur:

Analizimi i legjislacionit vendor, precedentët gjyqësor dhe politikat që identifikojnë lëmenjtë në të cilat nevojiten masat e veprimit pozitiv për të barazuar mundësitë e grupeve të veçanta të pafavorshme. Publikimi i raportit me rekomandime të posaçme. Angazhimi dhe lobimi që t'i shtynjë ato si propozime politike për qeverinë.

Analizimi i legjislacionit vendor, precedentët gjyqësor dhe politikat që identifikojnë dispozitat dhe praktikat e diskriminimit të drejtpërdrejt ose të tërthortë. Publikimi i raportit dhe angazhimi në lobim për reforma legjislative/politike. Prurja e procesit gjyqësor me ndikim për të asgjësuar jurisprudencën diskriminuese.

Monitorimi i precedentëve gjyqësor që implementojnë LKD, dhe pas disa viteve të zbatimit, analizimi dhe vlerësimi i precedentit gjyqësor sipas standardeve ndërkombëtare krahasuese dhe të barabarta. Publikimi i një raporti që identifikon pikat e forta si dhe ato të dobëta, dhe shpërndarja e raportit në të gjitha gjykatat e vendit

Rrjeti

Përparësitë e rrjetit me OJQ-të tjera, përfshirë këtu ato OJQ ndërkombëtare, janë se ne kemi mundësi të përfitojmë nga përvoja, të dihet si, dhe resurset e të tjerëve. Posaçërisht me partnerët ndërkombëtar, ka qenë përvoja e BHC në Bullgari e cila ka treguar se ato mund të jenë posaçërisht të dobishme për të grumbulluar raste krahasuese nga praktika gjyqësore, të cilat do t'i shpërndaheshin gjyqtarëve tanë për qëllim të arsimimit të tyre duke punuar ne profesion. Autoriteti i partnerëve ndërkombëtar do të mund të përdorej drejtpërsëdrejti në gjykatë duke i lejuar ata të intervendojnë në procedura si *amicus curiae* (miq të gjykatës), apo ndoshta edhe si parashtrues, qoftë në emër të viktimës apo duke përdorur të drejtën e vetë, aty ky e drejta procedurale lejon një gjë të tillë.

Përvoja e BHC-së për shembull përfshinë një partneritet të gjatë disavjeçar në konteste gjyqësore me **ERRC⁷-në**, gjatë të cilit ne së bashku i kemi iniciuar një numër të rasteve të diskriminimit racor në mbrojtje

⁷ www.errc.org. Të gjitha lidhjet janë dhënë më poshtë, përfshirë edhe këtë, të cilat për herë të fundit ishin shikuar më 11 mars 2007.

⁸ <http://www.mdac.info/index.html>.

⁹ www.interights.org.

¹⁰ <http://www.migpolgroup.com>.

¹¹ Partneriteti jonë me MPG ka qenë në kornizën e aktiviteteve të sponsoruar nga Komisioni Evropian.

¹² www.minorityrights.org.

¹³ <http://www.enar-eu.org/en>.

¹⁴ <http://www.socialplatform.org>.

¹⁵ <http://www.edf-feph.org/>.

të romëve në Bulgari. ERRC ka sponsoruar paditë, ka intervenuar si *amicus* dhe janë iniciuar veprime në dobi të përgjithshme nga vetë ne si paditës. Ngjashëm me këtë BHC ka një program të vazhdueshëm të përbashkët për mbrojtje juridike të personave me paaftësi mendore së bashku me Qendrën për Ndhim të Personave me Paaftësi (QNPP)⁸ në Budapest. **INTERIGHTS**, Londër,⁹ është një partner tjetër shumë i çmueshëm i cili në shumë raste ka ndihmuar juristët e BHC-së me material të vlefshëm ligjor nga shtetet tjera. Gjithashtu, juristët e BHC-së nganjëherë kanë kontribuar në punën e hartimit të përmbledhjeve të *amicus-i-it* për INTERIGHTS-in në rastet strategjike ndërkombëtare, siç është për shembull rasti *Nachova* pranë Gjykatës në Strasburg, si dhe konsultime për projektet strategjike dhe në mbajtjen e trajnimeve nga e drejta kundër diskriminimit për juristët. Një partner tjetër afatgjatë i BHC-së është Grupi për Politika të Migrimit (GPM),¹⁰ me seli në Bruksel. Së bashku me GPM-në kemi kryer një sërë hulumtimesh dhe analizash krahasuese të legjislacionit Bullgar kundër diskriminimit dhe praktikave ekzistuese. Ne po ashtu kemi një projekt në vazhdim e sipër i cili i evidenton OJQ-të e përfshira në punën e kundër-diskriminimit, dhe mbajnë trajnime kundër diskriminimit për aktivistët e OJQ-ve, sindikatat, dhe punëdhënësit, ky projekt ka filluar në vitin 2005.¹¹ Juristët e BHC-së gjithashtu kanë ndihmuar ERRC me mbajtje të trajnimeve nga ligjet kundër diskriminimit në seminarët e organizuara nga ERRC dhe nga Grupi për të Drejtat e Minoriteteve nga Londra (GDM).¹²

Të gjitha këto OJQ ndërkombëtare mund të bëhen partnere edhe me OJQ-të e Kosovës. OJQ tjera të forta ndërkombëtare të përshtatshme për partnere për grupet e barazisë përfshijnë ndër të tjera: Rrjeti Evropian Kundër Racizmit (RrEKR);¹³ **Platforma e OJQ-ve Sociale në Evropë**;¹⁴ Forumi Evropian për personat me paaftësi;¹⁵ **Shoqata ndërkombëtare e homoseksualëve dhe homoseksualeve (ShNHH-Evropë)**;¹⁶ Platforma Evropiane e personave të Moshuar; ¹⁷ **Përfshirja- Evropë**, një OJQ që punon për njerëzit me paaftësi intelektuale;¹⁸ **Shëndeti Mendor Evropë**;¹⁹ Unioni Evropian i të Verbërve;²⁰ Bashkimi Evropian i Vdekjes;²¹ **Autism – Evropë**, e cila mbron të drejtat e njerëzve që vuajnë nga autizmi;²² **Lobi i Femrave Evropiane**;²³ Iniciativa e Drejtësisë e Institutit të Shoqërisë së Hapur, të cilët janë mjaft aktiv në intervenimin strategjik në legjislacionin kundër diskriminimit në nivel ndërkombëtar.²⁴

Puna së bashku me OJQ-të tjera në një përpjekje të koncentruar drejt një qëllimi të përbashkët po ashtu ngritë edhe ndikimin tonë politik. Na lejon ne që të impresionojmë perceptimin e opinionit publik në një masë më të madhe. Prandaj, kur BHC e inicioi rastin e profilin të lartë të quajtur *Siderov* të përshkruar më lartë, ne e konsideruam se ishte më mirë që kjo të bëhej në emër të koalicionit të gjerë të shoqërisë civile të pagëzuar si “Qytetarët Kundër Urrejtes”, se sa vetëm në emër të BHC-në. Prandaj, kemi investuar mjaftë përpjekje dhe kohë, në mobilizimin e këtij koalicioni. Ia vlen, për këtë veprim ligjor, sikur të bëhej kjo vetëm në emër tonin, atëherë pa dyshim do të perceptohej më ndryshe nga gazetarët dhe opinionin publik dhe sigurisht do të ishte më pak në gjendje të kishte legjitimitet qendror dhe autoritet, se sa në rastin e tanishëm. Në këtë rast, vetë numri i OJQ-ve të përfshira (afër 70) ashtu me të gjithë shumëllojshmërinë e tyre (shoqata të gazetarëve, grupe të femrave, OJQ për mbrojtje të fëmijëve, OJQ ekologjike, grupe të personave me paaftësi, e kështu me radhë) kanë dërguar një mesazh të fortë i cili tregonte se padija përfaqëonte një dëshirë më të gjerë se të ishte padia e një grupi të njerëzve, siç është BHC.

¹⁶ <http://www.ilga-europe.org>.

¹⁷ <http://www.age-platform.org>.

¹⁸ <http://www.inclusion-europe.org>.

¹⁹ <http://www.mhe-sme.org>.

²⁰ <http://www.euroblind.org>.

²¹ <http://www.eudnet.org>.

²² <http://www.autismeurope.org>.

²³ <http://www.womenlobby.org>.

²⁴ <http://www.justiceinitiative.org>.

Burimet

Faqet e internetit e të gjitha OJQ-ve të përmendura më lart mund të përmbajnë informata të dobishme për OJQ-të e Kosovës të cilat janë të përfshira në punën për barazi. Disa OJQ ndërkombëtare, siç është **Instituti i së drejtës për interes publik që gjendet në Universitetin e Kolumbisë**, dhe **MRG** kanë krijuar dhe mirëmbajtur të dhënat shumë të dobishme për ligjin kundër diskriminues.²⁵ Faqja e internetit e INTERIGHTS përmban të dhëna të vlefshme për precedentët gjyqësore nga shumë juridiksione, si dhe *shënimet* e *miqve* për disa çështje të të drejtave të njeriut, duke përfshirë konceptet e barazisë. Në veçanti, shkresat e tyre për ndërrimin e barrës së provave në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejt, dhe në konceptin e dëshmimit të diskriminimit të tërthortë janë shumë të vlefshme.²⁶

Andaj, janë të qasshme resurset e dobishme kundër diskriminuese në faqet e internetit të **Komisionit Evropian (KE)**,²⁷ **Qendrës Evropiane për Monitorimin e Racizmit dhe Ksenofobisë (QEMRK)**,²⁸ që do të transformohet në Agjencinë KE-së për të Drejtat Fundamentale; **Komisioni i Këshillit të Evropës për Racizëm dhe Jo tolerancë (KKERJT)**;²⁹ **Ndër-grupi për persona me aftësi të kufizuara i Parlamentit Evropian**,³⁰ **Ndër-grupi kundër racizmit dhe për shumëllojshmëri i Parlamentit Evropian**.³¹

Literatura në vazhdim

Procesi strategjik gjyqësor i diskriminimit racor në Evropë, doracak i vlefshëm i ERRC, INTERIGHTS dhe MPG, i qasshëm.³²

Mos diskriminimi sipas të drejtës ndërkombëtare: Doracak për praktikantë, përpilim gjithëpërfshirës që mbulon çdo aspekt të temave në mbarë botën, gjithashtu i qasshëm në internet.³³

Të bindurit e interesit publik: Doracak për profesionistët dhe aktivistët ligjor, publikim i PILI për procesin gjyqësor me interes publik, gjithashtu i zbatueshëm për proces gjyqësor kundër diskriminimit.³⁴

Promovimi i Drejtësisë: Udhëzues praktik për avokim strategjik në të drejtat e njeriut, publikim i radhës për procedurat strategjike gjyqësore i zbatueshëm për rastet gjyqësore për sigurimin e barazisë.³⁵

²⁵ http://www.pili.org/dadel/index.php?title=Main_Page.

http://www.minorityrights.org/Legal/legal_themes_anti-discrimination.htm.

²⁶ At <http://www.interights.org/page.php?dir=Legalbriefs>, respektivisht, *Nachova v Bulgaria* dhe *D.H. dhe tjerët kundër Republikës Çeke*.

²⁷ http://ec.europa.eu/employment_social/fundamental_rights/public/pubst_en.htm (për KE dhe shoqëri civile, përfshirë listën e barazisë evropiane të OJQ-ve); http://ec.europa.eu/employment_social/fundamental_rights/civil/civ_en.htm; http://ec.europa.eu/employment_social/fundamental_rights/index_en.htm; http://ec.europa.eu/employment_social/fundamental_rights/roma/index_en.htm (mbi KE dhe Roma); http://ec.europa.eu/employment_social/fundamental_rights/policy/aneval/legnet_en.htm#comp (mbi Rrjetin i BE të ekspertëve ligjor për kundër diskriminim);

Ligji evropian kundër diskriminimit rishikimi dhe raportet tematike në

http://ec.europa.eu/employment_social/fundamental_rights/policy/aneval/legnet_en.htm#lawrev.

²⁸ <http://eumc.europa.eu/eumc/index.php>.

²⁹ http://www.coe.int/t/E/human_rights/ecri.

³⁰ <http://www.edf-feph.org/apdg/index-en.htm>.

³¹ <http://www.enar-eu.org/anti-racism-diversity-intergroup/>.

³² <http://www.migpolgroup.com/multiattachments/2497/DocumentName/litigation.pdf>.

³³ <http://www.interights.org/doc/Handbook.pdf>.

³⁴ <http://www.pili.org/en/content/view/352/53/>.

³⁵ http://www.globalrights.org/site/PageServer?pagename=wwd_promoting_justice.

Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës dhe Roli Ombudspersonit në të

Nga Hilmi Jashari³⁶

Diversiteti dhe mosdiskriminimi janë elemente bazë të një shoqërie bashkëkohore, ndërkaq zhvillimi i një sistemi ligjor demokratik nuk mund të paramendohet pa një ligj që ndalon të gjitha format e diskriminimit. Në të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe rajonale që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, tani përfshihen dispozitat për ndalimin e diskriminimit. Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës (LKD) është një hap i parë i domosdoshëm drejt krijimit të një kornize ligjore për luftimin e diskriminimit në të gjitha sferat e jetës publike, si dhe drejt dhënies fund të fenomenit të trajtimit të pabarabartë të individëve.

Në Kosovë, vetëdijesimi i shoqërisë në lidhje me parimin e diskriminimit dhe luftës kundër tij është ende është i ulët. Të gjitha raportet mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, në veçanti ato që kanë të bëjnë me grupet e ashtuquajtura 'të cenushme' të njerëzve siç janë komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, femrat, fëmijët, etj., bëjnë fjalë për marginalizim të madh të këtyre kategorive të njerëzve, duke konfirmuar kështu praninë e praktikave diskriminuese në të gjitha sferat e jetës publike.

Pikërisht për këtë arsye ka qenë me rëndësi shpallja e Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë në vitin 2004, si masë kryesore në luftimin e të gjitha formave të diskriminimit.

Krahas gjykatave lokale, Ligji Kundër Diskriminimit e identifikon edhe Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë (IOK) si organ i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave ku përfshihet diskriminimi, që përfshinë edhe ankesat lidhur me diskriminimin në sektorin privat. Madje edhe para miratimit të këtij ligji, në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e IOK-së thuhet se "Ombudspersoni u jep prioritet të veçantë akuzave për shkelje të rënda apo sistematike dhe atyre shkeljeve të bëra në baza diskriminuese. Në këtë nen me "veprat" nënkuptohen veprat, lëshimet dhe vendimet". Ky juridiksion përmendet qartë edhe në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, në Kreun 10 të së cilës thuhet "Avokati i popullit (Ombudspersoni) do t'u jep përparësi të veçantë pohimeve për shkelje të rënda ose sistematike, pohimeve me bazë diskriminimi, duke përfshirë diskriminimin ndaj komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe pohimeve për shkelje të të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre". Sërisht, në nenin 4 (1) të Rregullores së re të UNMIK-ut nr. 2006/6 thuhet, "Institucioni i Avokatit të Popullit ka këto përgjegjësi (...) të bëjë të njohur të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit, veçanërisht diskriminimin racor dhe etnik me ngritjen e vetëdijesimit publik, sidomos përmes informimit dhe edukimit dhe shfrytëzimit të mediave".

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë ka rol plotësues në zbatimin nga gjykatat të Ligjit Kundër Diskriminimit. Si mekanizëm për mbrojtje kundër diskriminimit, ky rol i ka disa përparësi krahasuar me procedurën gjyqësore. Pasi që vetë roli i Ombudspersonit është i një lloji ndërmjetësuesi ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve, procedurat në këtë institucion nuk janë formale dhe shpesh shumë më të shpejta se procedurat gjyqësore. Po ashtu, shërbimet e Institucionit të Ombudspersonit janë pa pagesë. Përparësi tjetër është ajo që Institucioni i Ombudspersonit mund të iniciojë hetime *ex officio*, nëse ka informata nga burime të ndryshme se mund të ketë ndodhur shkelja. Institucioni i Ombudspersonit ka të drejtë që në përputhje me juridiksionin e vet të japë këshilla dhe rekomandime për autoritetet publike. Megjithatë, Institucioni i Ombudspersonit nuk mund që, në një formë tjetër, t'i vë në zbatim këto rekomandime ose të sigurohet se ato janë implementuar. Kjo është ndryshe në vendet dhe rajonet e tjera ku Ombudspersoni mund të vë gjoba për veprim në mospërrputshmëri ose mund të iniciojë procedurë gjyqësore.

Sidoqoftë, madje edhe para themelimit të "Grupi për Mosdiskriminim" (tash e tutje: GMD), Ombudspersoni është përpjekur të ndërmarrë masa dhe të hetojë pohimet për praktika diskriminuese nga autoritetet publike. Në njërin nga këto raste, më 16 prill të vitit 2001, Ombudspersoni ka iniciuar një hetim *ex officio*

³⁶ Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit në Institucionin e Ombudspersonit të Kosovës.

lidhur me pohimet e paraqitura në Raportin Javor (3 prill - 9 prill 2001) të Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Sundim të Ligjit të Misionit të OSBE-së në Kosovë (OMIK). Sipas raportit, një punonjës serb i Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ishte ankuar lidhur me diskriminimin e supozuar sa i përket ofrimit të asistencës sociale për familjet e serbëve të Kosovës në atë komunë. Në këtë rast, raporti u publikua në vitin 2002, në të cilin Ombudspersoni i mëparshëm pas një hetimi konkludoi se nuk kishte patur shkelje të të drejtave të njeriut ose çfarëdo shpërdorimi të autoritetit në rastin e pikërisht.

Më 29 qershor të vitit 2005, Ombudspersoni publikoi një raport për rastin e Selvije Beqirit dhe të tjerëve kundër Hekurudhave të UNMIK-ut. Më parë Selvije Beqiri dhe të tjerët kishin punuar për Hekurudhat e UNMIK-ut. Kur ishin përjashtuar nga puna, ato kishin menduar se kjo ishte për shkak të faktit se ishin gra. Në raportin e Ombudspersonit të mëparshëm ishte konkluduar se kishte patur shkelje të të drejtës së aplikanteve për qasje në gjykatë, ashtu siç garantohet me nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Sipas LKD-së, Kreu II, neni 7.1. çdokujt i garantohet e drejta për qasje në gjykatën kompetente me qëllim të ushtrimit të ankesës kundër diskriminimit. Mirëpo, gratë që kishin punuar për Hekurudhat e UNMIK-ut dhe të cilat u ankuan se ishin përjashtuar nga puna në mënyrë diskriminuese, nuk mund ta dërgonin lëndën e tyre në gjykatë për shkak se Hekurudhat e UNMIK-ut, pjesërisht menaxhoheshin nga personeli i UNMIK-ut, të cilët sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, gëzojnë imunitet kundrejt procedurave civile dhe penale.

Institucioni i Ombudspersonit, qoftë duke iu referuar Ligjit Kundër Diskriminimit ose instrumenteve ndërkombëtare që e ndalojnë diskriminimin, po ashtu ka publikuar edhe një sërë raportesh në të cilat përfshiheshin çështjet e diskriminimit; raportet nxjerrëshin për çështjet siç janë diskriminimi për shkak të moshës dhe gjinisë nëpër shpalljet e konkurseve për punë në sektorin publik. Këto raporte bazoheshin në hulumtimet e përgjithshme të Ombudspersonit sa u përket disa shpalljeve të caktuara për vende të lira të punës dhe konkurse të shpallura në sektorin publik që publikoheshin në gazetën e përditshme "Koha Ditore" gjatë periudhave të caktuara kohore, në të cilat ishin caktuar kufizimet në moshë dhe ato gjinore ndaj kandidatëve potencialë. Ombudspersoni i rekomandoi Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm që ai të sigurojë që institucionet publike t'i respektojnë dispozitat përkatëse ligjore në lidhje me ndalimin e diskriminimit të bazuar në moshë sa përket qasjes në punësim, si dhe të rekomandojë që të gjitha këto raporte t'u shpërndahen të gjitha institucioneve publike. Mediat në Kosovë kanë qenë posaçërisht të interesuara për këto raporte; shumica e gazetave kryesore në Kosovë kishin shkruar artikuj rreth këtyre raporteve që u diskutuan në mesin e qytetarëve. Ky është një shembull se si institucioni mund t'i përdorë mediat në të ardhmen me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit publik mbi çështjen e diskriminimit.

Mirëpo, për shkak të mandatit të vet, Institucioni i Ombudspersonit ka funksion të dyfishtë në këtë aspekt – jo vetëm që përpiket ta luftojë diskriminimin me anë të hetimit të ankesave, ai po ashtu përpiket ta parandalojë atë duke inkurajuar zbatimin e duhur të ligjit dhe duke u angazhuar në promovimin e të drejtave të njeriut, ku përfshihet e drejta e secilit individ për të qenë i lirë nga çdo formë e diskriminimit.

Me qëllim të përbushjes së mandatit të vet në këtë aspekt, Ombudspersoni i mëparshëm, z. Marek Antoni Nowicki, në mars të vitit 2004 kishte themeluar të ashtuquajturin GMD në kuadër të Departamentit të Hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit. Juristët që punojnë për këtë grup, gjersa punojnë në ankesa të tjera të dorëzuara në Institucionin e Ombudspersonit, posaçërisht përqendrohen në rastet ku përfshihen të gjitha format e diskriminimit, përveç atyre që përfshijnë diskriminimin gjinor, me të cilat merret Njësia e veçantë për Barazi Gjinore në kuadër të Departamentit të Hetimeve. Zëvendës drejtori i Departamentit të Hetimeve i Institucionit të Ombudspersonit e koordinon grupin, krahas grupeve të tjera të posaçme në Departamentin e Hetimeve. GMD-ja përpiket sa më shumë që është e mundur të koordinohet me autoritetet publike në zgjidhjen e ankesave të tilla, por fatkeqësisht, përgjigja nuk ka qenë gjithmonë pozitive. Shpresojmë se duke shqyrtuar më shumë raste dhe duke promovuar vetëdijesim më

të madh për problemin, ne do të ndihmojmë që të tërheqim vëmendjen e autoriteteve ndaj diskriminimit dhe mënyrës së parandalimit të tij.

Në hetimet e GMD-së gjatë tre vjetëve të fundit janë përfshirë ankesa që kishin të bënin me ndalimin e shamisë së kokës së fesë islame për nxënëset nëpër shkolla; zbatimi jo i plotë i Ligjit mbi Pensionet për Personat me Aftësi të Kufizuara; problemet me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në përpjekje për të marrë patentë shoferi; mospagimi i pagave të shërbimit civil për pjesëtarët e komuniteteve pakicë; mungesa e financimit të qendrave mjekësore shumetnike; diskriminimi kundër pakicave në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim; mungesa e shkollimit fillor në gjuhën boshnjake për fëmijët boshnjakë; mungesa e çerdheve të fëmijëve për fëmijët boshnjakë; pamundësia që gjuha boshnjake të përdoret në gjykata, dhe sekuestrimi i diskriminues i automjeteve që fillimisht kanë qenë të regjistruara me tabela jugosllave. Disa prej këtyre rasteve janë zgjidhur pozitivisht në saje të intervenimit të Institucionit të Ombudspersonit, ndërsa të tjerat deri tani mbeten problem i të drejtave të njeriut.

Çështja tjetër që është shtruar gjatë këtyre vjetëve të fundit, si nga Ombudspersoni i mëparshëm, ashtu edhe nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, ka përfshirë ankesat e dorëzuara nga punonjësit serbë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, të cilët kanë pohuar se kanë qenë të përjashtuar nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve të tyre. Si Ombudspersoni i mëparshëm, ashtu edhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kanë rekomanduar që barra e dëshmisë në raste të tilla diskriminimi të bartet nga punonjësi i mëparshëm të punëdhënësi i mëparshëm, në përputhje me standardet evropiane dhe Ligjin Kundër Diskriminimit. Në fillim të këtij viti, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit është informuar nga Dhoma Speciale për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, që bartja e tillë e barrës së dëshmisë ka ndodhur, dhe nëse personat që ankohen për diskriminim mund të paraqesin dëshmi *prima facie*, se kundër tyre është ushtruar diskriminim, barra do të bie mbi punëdhënësin e tyre të mëparshëm që të dëshmojë se nuk ka patur diskriminim.

Më tej, Ombudspersoni ka publikuar një raport mbi praktikat diskriminuese në lidhje me ndarjen e apartamenteve nga komunat, ose në shpërndarjen e ndihmës komunale ndaj viktimave të një fatkeqësie natyrore. Aktualisht, GMD-ja është duke e përgatitur një raport pas ankesave kundër diskriminimit të parashtruara nga persona shqiptarë etnikë, të cilët më parë kanë punuar për Kompaninë Trepça/Trepça në Kosovën veriore, dhe në lidhje me përdorimin e gjuhëve të pakicave në zyrat e administratës qendrore dhe të asaj lokale.

Megjithatë, menjëherë pas konstituimit të GMD-së, juristët e përfshirë në këtë, e kuptuan se si rezultat i perceptimit të mangët dhe shpesh të njëanshëm të asaj se çka është në të vërtetë diskriminimi në pjesë të mëdha të shoqërisë kosovare, ka qenë e pamundur të punohet mbi ankesat kundër diskriminimit pa u angazhuar në aktivitete për ngritjen e vetëdijesimit. Kështu që, gjersa përqendrimi fillestar i GMD-së ka mbetur i njëjtë, ai është përfshirë gjithnjë më shumë në promovimin e artikujve kundër diskriminimit. Në aktivitetet e planifikuara për këtë vit hyjnë vizitat nëpër shkollat në mbarë Kosovën, vizitat te autoritetet publike në nivel lokal dhe qendror, si dhe publikimi i materialeve informative. Aktualisht, Institucioni i Ombudspersonit është duke kontaktuar edhe me OJQ-të siç është Iniciativa Rinore për të Drejta të Njeriut për të nxitur bashkëpunimin për këtë dhe për çështje të tjera të ndërlydhura. GMD-ja dhe Institucioni i Ombudspersonit, se bashku me këtë Iniciativë Rinore kishin planifikuar disa aktivitete promovuese për GMD-në në kuadër të IOK-së, për LKD-në dhe zbatimin e tij. Aktualisht GMD-ja është duke përgatitur materiale për fushatën siç janë: fletëpalosjet, afishet, fletët ngjitëse dhe bluza-t. GMD-ja planifikon t'i vizitojë të gjitha komunat e mëdha në Kosovë, posaçërisht ato të populluara me njerëz të etnive të ndryshme, ku ata planifikojnë të takohen me përfaqësues të autoriteteve publike komunale, përfaqësues të shoqërisë civile dhe me mësues, si dhe t'i shpërndajnë materialet e përmendura më lart. Me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit publik në lidhje me çështjen e diskriminimit, së bashku me OJQ-në Iniciativa Rinore për të Drejta të Njeriut, GMD-ja po ashtu ka planifikuar të organizojë një garë për veprën më të mirë pamore me temën "çka

kuptoni ju me diskriminim?" Materialet nga kjo garë do të ekspozohen në secilën komunë gjatë periudhës së GMD-së. Për më tepër, GMD-ja është duke u përpjekur të organizojë një koncert me muzikë pop për të rinj, për të promovuar mosdiskriminimin dhe GMD-në në Institucionin e Ombudspersonit.

Janë pikërisht problemet si këto që instrumentet si Ligji Kundër Diskriminimit janë përpjekur t'i zgjidhin duke i informuar njerëzit për atë se çka është diskriminimi – i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, dhe se ku mund të paraqiten ata për t'u ankuar. Sidoqoftë, deri më tani vet qëllimi i gjithë kësaj ka pësuar disfatë për shkak të mungesës së informatave në shoqërinë kosovare rreth ligjit dhe diskriminimit në tërësi. Shpesh diskriminimi ka shërbyer si argument në debatet e politizuara, ose është shfrytëzuar ku njerëzit janë ndier të fyer për një arsye ose tjetër, por ka patur shumë pak debate ose fushata publike përkitazi me vet natyrën e diskriminimit. Personat ose grupet e personave, të cilët në shumicën e rasteve janë të marginalizuara dhe shpesh të diskriminuar janë në pozitën më të keqe sa i përket të informuarit për këtë ligj. Kur një njeri parashtron kërkesë për leje ndërtimi dhe ajo i refuzohet, ndërsa fqinji i tij i cili ka një shtëpi të ngjashme në të njëjtin lokacion, i jep rryshfet zyrtarit përkatës të komunës dhe e merr lejen e ndërtimit, jo vetëm që është nepotizëm dhe korrupsion, por edhe diskriminim; dy njerëz në situatë të ngjashme trajtohen në mënyra të ndryshme mbështetur në baza të paarsyeshme. Mirëpo, viktimat e situatave të tilla rrallëherë ankohen për diskriminim për arsye se ata nuk dinë ta identifikojnë atë si të tillë.

Mungesa e informatave në domenin publik nuk është arsyeja e vetme për moszbatimin e këtij ligji. Autoritetet ekzekutive nuk e dinë përmbajtjen e ligjit dhe deri më tani nuk e kanë patur prioritet zbatimin e tij. Po ashtu, në shumë gjykata, ka një vetëdijesim të kufizuar për ligjin dhe për mënyrën e zbatimit të tij. Kur një jurist nga GMD-ja e pyeti gjykatën nëse kishte ndonjë rast të pazgjidhur diskriminimi në gjykatë, gjykata ka qenë shumë e befusuar dhe nuk ka qenë në dijeni të asnjë rasti të tillë. Juristët e ankuësve gjithashtu duhet të jenë më aktivë në sfidimin e gjykatave kur paraqesin ndonjë rast. Zbatimi do të përmirësohej nëse do të ekzistonte një organizatë e specializuar ose OJQ, që do të kishte juristë me përvojë në rastet e diskriminimit, sidomos nëse ata kanë punuar në kuadër të një kornize për ndihmë ligjore.

Megjithëse Ligji Kundër Diskriminimit nuk është i përkryer dhe sigurisht që ka nevojë për rishikim, (sidomos sa i përket disa përkufizimeve dhe parimeve që mbeten mjaft të paqarta), kjo nuk e arsyeton mungesën e zbatimit të tij gjatë dy vjetëve e gjysmë të fundit. Është me rëndësi që Qeveria të angazhohet në mënyrë aktive në përcjelljen e zbatimit të këtij ligji me anë të organizimit, për shembull, të fushatave të vazhdueshme të ngritjes së vetëdijesimit publik. Është me rëndësi që çdo fushatë informuese të trajtojë problemin e padijes për këtë ligj nga të dyja palët – njerëzit duhet të informohen rreth tij, ndërsa ekzekutivi dhe gjyqësori duhet të trajnohen si duhet për atë se si t'i trajtojnë ankesat në të ardhmen.

Vetëm atëherë kur të ketë vetëdijesim më të madh të publikut për atë se çka është diskriminimi (dhe çka ndalohet me ligj), do të krijohet sistemi ku do të kërkohet që për ato ankesa të vendosin organet më të larta administrative dhe gjykatat. Kërkohet veprim i menjëhershëm, ose mbrojtja e duhur e të drejtave të njeriut në këtë fushë shumë të rëndësishme për të gjithë do të mbetet hiç më shumë se një përrallë.

Ligji Kundër Diskriminimit si masë për Ndërtimin e Besimit për Kosovë

Nga Nuno Luzio³⁷

1. Hyrje

Dekretimi i Ligjit kundër Diskriminimit³⁸ (më tej në tekst LKD) paraqet nga shembujt e bashkëpunimit të mirë dhe produktiv mes Qeverisë së Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare, duke shfrytëzuar praktikat më të mira ndërkombëtare.³⁹ Jo vetëm që OSBE-ja theksoi nevojën për një ligj të tillë qysh prej vitit 2000⁴⁰, por edhe ndihmoi hartimin e ligjit përmes Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit të Misionit të OSBE-së në Kosovë.⁴¹

Iniciativa ishte në pajtim me nevojën për harmonizimin e legjislationit të brendshëm me standardet evropiane, siç është përshkruar në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë:

“Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes do të jenë përgjegjëse për harmonizimin e legjislationit dhe praktikave të tyre me standardet dhe normat evropiane dhe ndërkombëtare brenda të gjitha fushave të përgjegjësive me qëllim të caktuar për lehtësimin e vendosjes së lidhjeve ekonomike, shoqërore dhe lidhjeve të tjera të popullit të Kosovës me popujt e tjerë evropianë dhe me vetëdije se respektimi i standardeve dhe i normave të tilla do të zërë vend qendror për zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin euroatlantik.”⁴² Ngjashëm, LKM iu përmbajt dispozitës së nenit 3.1 të së njëjtës Kornizë: “Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.”⁴³

Më 30 korrik 2004, Kuvendi i Kosovës miratoi “një nga ligjet më gjithëpërfshirës dhe të hollësishtëm vendorë të botës që ndalojnë diskriminimin.”⁴⁴ Ligji hyri në fuqi më 19 shtator 2004, pas shpalljes së tij nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm më 20 gusht 2004.⁴⁵

Ligji ka tri funksione kryesore. Së pari, “ai konsolidon dhe përforcon ligjin aktual kundër diskriminimit në Kosovë duke e përshtatur atë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane kundër diskriminimit”; më tutje, “ai promovon uniformitetin në gjykimin e formave të ndryshme të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin në punësim, në qasje ndaj shërbimeve themelore” dhe përfundimisht “ai ofron mjete juridike

³⁷ Autori është Zyrtar i Ri Profesional në Njësinë Qendrore të Departamentit të Qeverisjes së Mirë dhe Institucioneve Demokratike të Misionit të OSBE-së në Kosovë në Kuvend. Ai ka punuar më herët në Qendrën e OSBE-së për Parandalimin e Konfliktëve në Vjenë. Ai ka diplomë në Drejtësi (Universiteti i Coimbras, Portugali) dhe Magjistër I Arteve në Studimet Ndërkombëtare/Studimet për Paqe dhe Konflikte (Universiteti i Tokios për Studime të Huaja, Japoni).

³⁸ Ligji nr. 2004/3.

³⁹ Baldwin, Clive (2006) “Të Drejtat e Pakicave në Kosovë nën Sundimin Ndërkombëtar” (Minority Rights in Kosovo under International Rule), MB, Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Pakicave, f. 18.

⁴⁰ OSBE/UNHCR (2000) “Vlerësimi i Situatës së Pakicave Etnike në Kosovë (Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo) (Vlerësim i Pestë), Prishtinë/Pristina, OSBE/UNHCR.

⁴¹ Fabian, Gregory – “Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë: Plan që ka nevojë të ekzekutohet” (Implementation of the Anti-Discrimination Law in Kosovo: A Plan in Need of Execution), gjendet në adresën <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2459&archiv=1>.

⁴² Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, UNMIK/REG/2001/9, Kreu 5.7.

⁴³ Po aty, Kreu 3.1.

⁴⁴ Cahn, Claude (2007) “Lindja e një Kombi: Kosova dhe Persekutimi i Pakicave të Përgjashtuara” (Birth of a Nation: Kosovo and the Persecution of Pariah Minorities), *Revista Juridike Gjermane*, 8 (1), pa faqe, në dispozicion në faqen <http://germanlawjournal.com/print.php?id=790>.

⁴⁵ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/32 për Shpalljen e Ligjit Kundër Diskriminimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës e 20 gushtit 2004.

dhe administrative për viktimat e çfarëdo forme të diskriminimit, si dhe sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse për t'i trajtuar shkeljet në sektorin privat dhe atë publik.”⁴⁶

2. Analiza e Ligjit

Një nga aspektet kryesore interesante të LKM-së është se ai jo vetëm që përputhet me disa standarde ndërkombëtare dhe evropiane, por shkon më tej në atë që synon të mbrojë.

Ligji i përmbahet dy direktivave kryesore evropiane: Direktiva e Këshillit të Bashkimit Evropian 2000/43/EC, e 29 qershorit 2000 dhe Direktiva e Këshillit 2000/78/EC e 27 nëntorit 2000. Direktiva e parë zbaton parimin e trajtimit të barabartë mes personave, pa marrë parasysh prejardhjen racore dhe etnike, derisa tjetra përcakton kornizën e përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, duke ndaluar diskriminimin në bazë të fesë apo besimit, paaftësisë, moshës apo orientimit seksual.⁴⁷ Megjithatë, derisa Direktiva 2000/43/EC ndalon diskriminimin e drejtpërdrejt dhe të tërthortë në bazë të prejardhjes racore apo etnike, neni 2 i LKM-së ndalon diskriminimin në çfarëdo baze. Në lidhje me pikën e fundit, ligjvënësi ka ndjekur Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, neni 21 (1).⁴⁸ Më tej, e njëjta Direktivë kufizon gamën e të drejtave që mbrohen, derisa neni 4 i LKM-së ndalon diskriminimin në qasjen dhe gëzimin e secilës së drejtë të përcaktuar me ligjet e zbatueshme.⁴⁹

2.1. Kapitulli I

Qëllimi i LKM-së është të parandalojë dhe luftojë diskriminimin, si dhe të zbatojë parimin e trajtimit të barabartë të gjithë njerëzve të Kosovës nën sundimin e ligjit⁵⁰. Ligji bazohet në tri parime: parimin e trajtimit të barabartë⁵¹, përfaqësimit të drejtë⁵² si dhe kuptimin e mirë dhe tolerancën mes kombeve.⁵³ Ligji përfiton nga një parim mjaft i gjerë i trajtimit të barabartë siç është përmendur më herët. Ligjvënësi ka ndaluar diskriminimin në bazë të bazave të dhëna, por në mënyrë të qartë zgjeron këtë ndalim në çfarëdo baze. Një aspekt tjetër interesant është që diskriminimi është i ndaluar në një apo disa baza. Kjo është në veçanti e rëndësishme kur zbatohet në një shoqëri të ndarë në vija etnike si në Kosovë. Do të thotë që diskriminimi mund të ketë bazë të shumëfishtë, për shembull një grua rome mund të diskriminohet në baza gjinore apo etnike, ose të dyja bashkë. Kjo mundësi e zgjeron shumë fushëveprimin e ligjit.

Neni 3 ofron një shpjegim të qartë për format e ndryshme të diskriminimit. Diskriminimi i drejtpërdrejt është lloji më klasik i tij. Ai thekson që trajtimi duhet të jetë i barabartë dhe të mbrojë secilin individ apo grup që të mos ketë më pak qasje ndaj një shërbimi apo më pak mbrojtje të bazuar në njërin nga bazat e përcaktuara. Megjithatë, dallimi i trajtimit në bazë të njëjërës prej bazave të ndaluara mund të lejohet kur “për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara

⁴⁶ Chirizzi, Katja (2004) “Ligji kundër Diskriminimit nënshkruar dhe shpallur nga PSPP-ja (Anti-Discrimination Law signed into law by the SRSG), në *Buletinin për Mbështetje të Iniciativave të Kuvendit, nr. 13*, Prishtinë, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

⁴⁷ Direktiva e Këshillit 2000/43/EC që zbaton parimin e trajtimit të barabartë mes personave, pa marrë parasysh prejardhjen racore dhe etnike (Gazeta Zyrtare L 180 e 19 korrikut 2000, pp. 22-26) dhe Direktiva e Këshillit 2000/78/EC që përcakton kornizën e përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe arsim (Gazeta Zyrtare L 303 e 2 dhjetorit 2000, pp. 16-22).

⁴⁸ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Nicë, dhjetor 2000, në dispozicion në faqen http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf.

⁴⁹ Fabian, Gregory: “Zbatimi i Ligjit kundër Diskriminimit në Kosovë: Plan që ka nevojë të ekzekutohet” (Implementation of the Anti-Discrimination Law in Kosovo: A Plan in Need of Execution), në dispozicion në faqen <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2459&archiv=1>.

⁵⁰ Ligji nr. 2004/3, neni 1.

⁵¹ Po aty, neni 2 (a).

⁵² Ligji nr. 2004/3, neni 2 (b).

⁵³ Po aty, neni 2 (c).

profesionale, me kusht që qëllimi të jetë legjitim e kërkesat proporcionale me qëllimin.⁵⁴ E njëjta gjë ndodh edhe me “masat për parandalimin apo kompensimin për disavantazhet e lidhura me bazat (...), me kusht që kjo të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.”⁵⁵

Mosdiskriminimi nuk është i kufizuar vetëm në trajtimin e personave në mënyrë të barabartë. Kështu, LKM lufton edhe diskriminimin e tërthortë.⁵⁶ Ndalimi i diskriminimit të tërthortë është i dobishëm për “de-maskimin e rasteve të diskriminimit të qëllimshëm të cilat kërkojnë të arrijnë në mënyrë të tërthortë atë që nuk mund të bëhet drejtpërdrejt” ose për të “ripunuar në mënyrë të përhershme zakonet dhe procedurat e institucionalizuara, për t’i bërë ato më mikpritëse ndaj ndryshimeve.”⁵⁷ Megjithatë, ligjvënësi nënvizon që nëse dispozita, kriteri apo praktika në mënyrë objektive arsyetohet me një qëllim legjitim dhe mjetet për ta bërë atë janë të përshtatshme, një gjë e tillë nuk mund të konsiderohet diskriminim i tërthortë.⁵⁸

Sipas LKM-së, ngacmimi konsiderohet diskriminim, një sjellje kundër dëshirës, e cila ka për qëllim apo ndikim në shkeljen e dinjitetit të një personi.⁵⁹ Kjo do të thotë që ligjvënësi ka marrë parasysh jo vetëm synimin, por edhe rezultatit e kësaj sjelljeje. Në këtë kuptim, ligjvënësi ndoshta do të duhej të shkonte pak më tutje, duke mbrojtur jo vetëm personat, por edhe grupet.

Ligji konsideron diskriminimin jo vetëm si veprim i ndërmarrë nga një individ kundër një tjetri, por edhe udhëzimin që i është dhënë dikuajt për të diskriminuar.⁶⁰

Gjithashtu, diskriminim është edhe një reagim hakmarrës i ndërmarrë në përgjigje ndaj një ankese apo masave që synojnë të zbatojnë përputhjen me parimin e trajtimit të barabartë.⁶¹ Përfundimisht, ligji definon segregimin si ndarje të një apo më shumë individëve nga të tjerët në cilëndo bazë, përveç nëse një veprim i tillë është i justifikueshëm në mënyrë objektive.⁶² Është me rëndësi të thuhet që sipas standardeve bashkëkohore ligjore, edhe nëse një grup ka të njëjtën qasje ose edhe qasje më të mirë ndaj shërbimeve, fakti që ajo i mban larg nga të tjerët është formë e diskriminimit.⁶³

Neni 4 është i qartë sa i përket fushëveprimit të zbatimit. Fushëveprimi është tejet i gjerë dhe e bën secilin njëkohësisht “bartës të detyrimeve dhe bartës të të drejtave.”⁶⁴ LKM-ja është novator në kuptimin që jo vetëm përfshin veprimin apo mosveprimin që shkel të drejtat e cilltdo person fizik apo juridik, por edhe përcakton të drejtat e rëndësishme (punësimi, arsimi, mbrojtja sociale, trajtimi i drejtë para gjykatave, etj.), pa përjashtuar asnjë të drejtë tjetër të përcaktuar me ligjet në zbatim.⁶⁵

Siç është përmendur më herët, ligji nuk lë pa përmendur veprimin pozitiv. Kjo pikë ka rëndësi të veçantë kur flitet për ndryshimin e sjelljeve diskriminuese. Në pikëvështrimin ligjor, nuk ka kurrfarë dallimi. Veprimi pozitiv mund të mos krijojë rrezikun e diskriminimit kundër anëtarëve të një grupi, por ka situata tjera ku një veprim pozitiv paraqet një rrezik të tillë, të ashtuquajtur veprim afirmativ. Për shembull, nëse një punëdhënës shpall konkursin për punë në një gazetë e cila synon anëtarët e një komuniteti të veçantë

⁵⁴ Ligji nr. 2004/3, neni 5.

⁵⁵ Po aty, neni 6 (6.1.).

⁵⁶ Po aty, neni 3 (b).

⁵⁷ De Schutter, Olivier (2005) “Tre Modelet e Barazisë dhe Ligji Evropian Kundër Diskriminimit (Three Models of Equality and European Anti-Discrimination Law), *Revista Tremujore Juridike e Irlandës Veriore*, 57 (1), f. 9.

⁵⁸ Ligji 2004/3, neni 3 (b).

⁵⁹ Po aty, neni 3 (c).

⁶⁰ Po aty, neni 3 (d).

⁶¹ Po aty, neni 3 (e).

⁶² Ligji nr. 2004/3, neni 3 (f).

⁶³ Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut (2007) “Raporti mbi Zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit” (Report Implementation of Anti-Discrimination Law), Prishtinë, p. 9.

⁶⁴ Po aty, Prishtinë, f. 9.

⁶⁵ Ligji nr. 2004/3, Neni 4 (n).

etnik, apo inkurajon femrat apo pakicat të konkurrojnë, nuk mund të shihet si kundërtënie me parimin e trajtimit të barabartë.⁶⁶ Për të zbatuar ligjin në sferën publike, ligjvënësi përmend se të gjithë personat që ushtrojnë funksione publike kur ofrojnë kontratë, hua, grant apo përfitime tjera duhet të sigurojnë që ato palë do të jenë në përputhje me ligjin.⁶⁷

2.2. Kapitulli II

Në kuptimin e procedurave dhe sanksioneve, ligji është i qartë dhe ofron disa mundësi të ushtrimit të ankesës. Në nenin 7 (7.6) ligji parashikon përfshirjen e shoqatave, organizatave apo subjekteve tjera ligjore në fuqizimin e obligimeve të përligjura brenda tij.⁶⁸ Kjo gjë është me rëndësi të veçantë në një shoqëri si Kosova, ku banori mesatar nuk do ketë qasje të lehtë ndaj drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile janë palë me interes në zbatimin e ligjit.

Në çështjet e barrës së provave, ligji i jep viktimës apo viktimave një mënyrë të mundshme të provimit të diskriminimit. Ligji përshkruan bartjen e barrës në rastet civile, pasi të jetë vërtetuar që rasti është *prima facie*, duke kërkuar nga pala e paditur të “dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.”⁶⁹ Më tutje, faktet e tilla mund të vërtetohen edhe me dëshmi statistikore.⁷⁰ Edhe një herë, ligji i përmbahet Direktivës 2000/43/EC në nenin 8 (1) dhe pikën 15.⁷¹

Sa i përket sanksioneve, LKM-ja përcakton kompensimin për dëmet materiale dhe morale përmes gjobave.⁷² Një aspekt tjetër interesant i ligjit është që ai i mundëson gjykatës të sanksionojë masa pozitive.⁷³ Përfundimisht, gjitha paratë që vijnë nga gjobat do të vendosen në një fond të veçantë, i cili do të dedikohet për ndihmë juridike falas.⁷⁴

2.3. Kapitulli III

Sa i përket promovimit të trajtimit të barabartë, LKM-ja mbështetet fuqimisht tek Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë.⁷⁵

2.4. Kapitulli IV

Kapitulli përfundimtar i ligjit përcakton vlerën e tij juridike, pasi ligji mbizotëron gjitha ligjet e mëparshme të zbatueshme në këtë fushë, si dhe lejon zbatimin e dispozitave tjera ligjore nëse ato janë më të favorshme sesa LKM-ja.⁷⁶

Për më shumë, ligji i jep Qeverisë mundësinë të miratojë akte nënligjore, me qëllim të zbatimit të ligjit.⁷⁷ Në fakt, Qeveria në pajtim me ligjin është përgjegjëse për udhëheqjen e një programi të vetëdijesimit publik⁷⁸,

⁶⁶ De Schutter, Olivier (2005) “Tre Modelet e Barazisë dhe Ligji Evropian Kundër Diskriminimit (Three Models of Equality and European Anti-Discrimination Law), *Revista Tremujore Juridike e Irlandës Veriore*, 57 (1), p. 33..

⁶⁷ Ligji nr. 2004/3, neni 6 (6.2).

⁶⁸ Po aty, neni 7 (7.6).

⁶⁹ Po aty, neni 8 (8.1.).

⁷⁰ Ligji Nr. 2004/3, neni 8 (8.2.).

⁷¹ Direktiva e Këshillit 2000/43/EC që zbaton parimin e trajtimit të barabartë mes personave, pa marrë parasysh prejardhjen racore dhe etnike (Gazeta Zyrtare L 180 e 19 korrikut 2000, pp. 22-26).

⁷² Ligji nr. 2004/3, neni 9 (9.2.).

⁷³ Po aty, neni 9 (9.3.).

⁷⁴ Po aty, neni 9 (9.4.).

⁷⁵ Po aty, neni 10.

⁷⁶ Po aty, neni 11.

⁷⁷ Po aty, neni 12 (12.3.).

⁷⁸ Po aty, neni 13 (13.2.).

i cili është ndërmarrë nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore brenda Zyrës së Kryeministrit (më tutje në tekst ZQM).

3. Përparesitë dhe mangësitë e procesit të implementimit

Siç është përmendur më lart, LKM-ja duhet konsideruar si pjesë e avancuar dhe e rëndësishme e legjisla-cionit në Kosovë. Megjithatë, implementimi i tij nuk ka qenë aq i suksesshëm sa është dëshiruar.

Ligji përcakton dispozita shumë të qarta dhe zbaton standardet ndërkombëtare dhe evropiane në përm-bajtjen e tij të përgjithshme. Megjithatë, për shembull, nuk ka ndonjë regjistrim të numrit të kontratave, huave apo granteve publike të dhëna nga sektori publik të cilat kanë pasur ndonjë dokument që thekson përputhshmërinë e tyre me LKM-në, siç është përshkruar në nenin 6 (6.2.). Përveç kësaj, deri sot nuk është themeluar Qendra për Trajtimin e Barabartë, siç është parashikuar me nenin 9 (9.5.). Vijimisht, do të ishte me rëndësi të themelohet Qendra, me mandat të qartë, për të mos u ndërthurrur me mandatin e Institucionit të Ombudspersonit. Përveç këtyre, secili organ publik duhet të obligohet të veprjë sipas nenit 6 (6.2.), gjegjësisht të përcaktojë një mënyrë që të sigurojë që gjithë përfituesit e një kontrate, huaje, granti ose përfitimi tjetër publik të jenë plotësisht të vetëdijshëm mbi obligimet e parashikuara me ligj.

Për shkak të natyrës së tij ligjore, parashihet që Institucioni i Ombudspersonit të jetë organi përgjegjës për promovimin e trajtimit të barabartë në Kosovë.⁷⁹ Megjithatë, sa i përket implementimit, do të ishte shumë e rëndësishme të angazhohet jo vetëm Qeveria si parashihet me ligj, por edhe Kuvendi i Kosovës. Roli i secilit Kuvend në botë është, veç tjerash, edhe mbikëqyrja e implementimit të ligjeve që ka miratuar vet. Kështu, është me rëndësi të avancohet roli i Kuvendit në mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të ligjit, gjë që ka ndodhur rrallë, përkundër rëndësisë që ka.

Qeveria ka përgjegjësi të veçanta për zbatimin e LKM-së, kryesisht përmes ZQM-së. Duke zbatuar Ud-hëzimin Administrativ mbi Implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit, nr. 04/2006 (të miratuar nga Qeve-ria), ZQM-ja është organi përgjegjës për zbatimin e ligjit. Udhëzimi i lartpërmendur përkufizon rregullat praktike, mjetet strukturale dhe fizike për zbatimin e LKM-së si dhe promovimit të trajtimit të barabartë për gjithë personat.⁸⁰

Por, Qeveria nuk ka përligjur veprimet e veta në këtë udhëzim, pasi më 11 tetor 2005, ajo miratoi Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për Implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Plani duhet të zbatohet në periudhën 2005-2007 dhe ai përfshin synimet⁸¹, veprimet, palët me interes, resurset dhe një kornizë ko-hore. Përparesia e planit është që ai kombinon sinergjitë me përfshirjen e disa agjencive qeveritare dhe jo-qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare. Por, suksesi i këtij plani mbetet të vlerësohet.

Një udhëzim tjetër i rëndësishëm është Udhëzimi Administrativ nr. 8/2005 që përcakton detyrat dhe kush-tet e punës së Koordinatorëve për të Drejtat e Njeriut, që themelojnë Njësitë e të Drejtave të Njeriut në secilën ministri. Këto njësi synojnë të provojnë, avancojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut⁸² përmes

⁷⁹ Po aty, neni 10; Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, UNMIK/REG/2001/9, Kapitulli 10.

⁸⁰ Zyra e Qeverisjes së Mirë – Zyra e Kryeministrit (2006) *Raport (janar-qershor 2006) për aktivitetet në fushat e Kundër-Diskriminimit, Anti-Korupsionit, Anti-Trafikimit të qenieve njerëzore dhe të Drejtave Njerëzore, Prishtinë, ZQM-ZKM, f. 7.*

⁸¹ Inicimi i mekanizmit të procesit/koordinimit pjesëmarrës për zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit (LKM) për përfshirje të palëve përgjegjëse si dhe përkushtimit të tyre të vërtetë për zbatimin e LKM-së; identifikimin dhe konfirmimin e përkushtimit dhe përgjegjësisë së institucioneve të propozuara për zbatimin dhe mbikëqyrjen e LKM-së, si dhe hapave të rekomanduar për të ardhmen; identifikimi i agjencive përgjegjëse nga sektori qeveritar dhe ai joqeveritar për zhvillimin e një moduli gjithëpërfshirës trajnimi mbi LKM-në dhe ofrimin e këtyre trajnimeve; konsolidimin e legjis-lacionit dhe procedurave për trajtimin e rasteve kundër diskriminimit, si dhe qartësimin e procedurave të reja, nëse ka nevojë; shpërndarjen përfshirëse të informatave mbi aplikimin dhe zbatimin e LKM-së.

⁸² Udhëzimi Administrativ nr. 8/2005 për kushtet e referimit për Njësitë e të Drejtave të Njeriut, neni (2.2.).

aplikimit të dokumenteve të miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi si dhe procesit të raportimit mbi aspektin e të drejtave të njeriut në secilën ministri.⁸³ Një nga përgjegjësitë e këtyre zyrtarëve është promovimi i parimeve të përligjura me LKM-në. Mirëpo, këto njësi kanë pasur probleme, meqë koordinatorët dhe anëtarët e tyre nuk kanë kontrata pune e as përshkrim të detyrave për fushat në të cilat janë përgjegjës. Për më shumë, pozita e tyre është detyrë shtesë për ta përveç shumë tjerash.⁸⁴ Kjo do të thotë që shumë nga këta zyrtarë duhet të përgjigjen para mbikëqyrësve tjerë, gjë që nuk kontribuon në autonominë e punës së tyre. Fatmirësisht, një Udhëzim Administrativ është në përgatitje, i cili do të sigurojë institucionalizimin e Njësisve, gjë që do të kontribuojë në avancimin e pavarësisë së tyre, duke qartësuar përgjegjësitë dhe duke harmonizuar pagat dhe përfitimet në gjitha ministrinë.

Përkundër gjitha iniciativave, legjislacioni progresiv nuk u përcoll me përpjekje të duhura të ngritjes së vetëdijes dhe mbështetja ndaj këtyre përpjekjeve duket e pamjaftueshme.⁸⁵ Për shembull, në lidhje me mbrojtjen e pakicave, duket që jo vetëm njerëzit kanë qenë të panjohur me ligjin, por edhe qasja ndaj drejtësisë nuk duket e lehtë. Ekziston një mungesë e një sistemi efektiv të ndihmës juridike, derisa ka një ngarkesë masive të lëndëve që presin në gjykata.⁸⁶ Përveç këtyre, numri i personave nga komunitetet pakicë që punojnë në strukturat juridike është proporcionalisht i ultë, gjë që vështirëson edhe ndërtimin e besimit në strukturat juridike.⁸⁷

Për të përmbledhur, ka shumë për t'u bërë dhe Qeveria nuk duhet të dorëzohet në përpjekjen e përafrimit të gjithë palëve me interes përreth këtij qëllimi dhe nga trajtimi i disa problemeve të përmendura më herët.

Përfundimisht, është me rëndësi të theksohet përfshirja konstante e Misionit të OSBE-së në Kosovë qysh prej fillimit. Siç është shpjeguar tanimë, OSBE-ja është përfshirë në mënyrë aktive në hartimin e ligjit. Më 2004, OSBE-ja ishte përgjegjëse për organizimin e një punëtorie të rëndësishme me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë, shoqërisë civile dhe bashkësisë ndërkombëtare. Punëtorja doli me rekomandime që duheshin konsideruar si udhëzime për zbatimin e ligjit.⁸⁸ OSBE-ja përkrahu edhe hartimin e Planit Gjithpërfshirës të Veprimit. OSBE-ja dërgoi Këshilltarë të Lartë për të Drejtat e Njeriut në secilën Ministri dhe njëkohësisht trajnoi anëtarët e njësisve për të Drejtat e Njeriut. Bashkëpunimi shkoi deri në masën ku në disa ministri, ankesat dorëzoheshin tek OSBE-ja për vlerësim dhe mendim. Përfundimisht, Misioni përkrahu Institutin Gjyqësor të Kosovës në trajnimin e gjykatësve dhe avokatëve. Përpjekjet e Misionit kanë filluar të vjelin frytet, por investimi duhet të vazhdojë në një perspektivë afatgjatë. OSBE-ja gjithmonë ka qenë tejet e përkushtuar në zbatimin e LKM-së dhe sigurisht që do të vazhdojë të jetë kështu edhe në të ardhmen.

⁸³ Po aty, neni 3.

⁸⁴ Zyra e Qeverisjes së Mirë – Zyra e Kryeministrit (2006) *Raport (Janar-qershor 2006) për aktivitetet në fushat e Kundër-Diskriminimit, Anti-Korrupsionit, Anti-Trafikimit të qenieve njerëzore dhe të Drejtave të Njeriut Njerëzore, Prishtinë, ZQM-ZKM, f. 20.*

⁸⁵ Komiteti Këshillëdhënës mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (2006) *Mendime mbi Zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë (Opinion on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities in Kosovo)*, Strasburg, Këshilli i Evropës, Neni 4; në dispozicion në faqen www.ian.org.yu/kosovo-info/english/files-index/1st_OP_Kosovo_English.pdf;

⁸⁶ Amnesty International (2006) *Të drejtat e njeriut në Kosovën e pas-statusit (Human Rights protection in post-status Kosovo/Kosova): Rekomandimet e Amnesty International në lidhje me bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës, Kosovë/Kosovo (Serbia)*, Amnesty International, Pika 8.3.

⁸⁷ Komiteti Këshillëdhënës mbi Konventën e konventës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (2006) *Mendime mbi Zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë (Opinion on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities in Kosovo)*, Strasburg, Këshilli i Evropës, neni 4; në dispozicion në faqen www.ian.org.yu/kosovo-info/english/files-index/1st_OP_Kosovo_English.pdf;

⁸⁸ Shih Fabian, Gregory: “Zbatim i Ligjit kundër Diskriminimit në Kosovë: Plan që ka nevojë të Ekzekutohet” (Implementation of the Anti-Discrimination Law in Kosovo: A Plan in Need of Execution), në dispozicion në faqen <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2459&archiv=1>.

4. Konkludim

Pas analizimit të ligjit dhe procesit të implementimit të tij, është me rëndësi të konkludohet duke sqaruar rëndësinë e LKM-së në gjendjen e tanishme.

Neni 2 (2.3.) i Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin, paraqitur nga i Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisaari, nënvizon si në vijim: “Kosova do të marrë gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e personave që mund t’i nënshtrohen kërcënimeve apo veprave të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës si rezultat i identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.”⁸⁹ Asnjë instrument nuk do ta plotësonte obligimin e lartpërmendur më mirë sesa LKM-ja. Është e qartë se ligji jo vetëm që synon mbrojtjen e pakicave, por ka një fushëveprim edhe më të gjerë në zbatim. Por, askush nuk mund të mohojë që LKM-ja është instrument kyç për mbrojtjen e pakicave në Kosovë, gjë që ka rëndësi jetike në gjendjen e tanishme. Kjo është theksuar si një nga tre parimet në bazë të LKM-së, që është saktësisht parimi i mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike.⁹⁰ Por, askush nuk duhet të harrojë që “pasi sigurimi i të drejtave të pakicave në formë të të drejtave të komuniteteve është faktor thelbësor për shtetin e ardhshëm të Kosovës, nuk ka nevojë as të përmendet që masat pozitive (...) janë të nevojshme për t’i bërë pakicat të ndjehen personalisht të sigurt në Kosovë dhe për t’u dhënë atyre një perspektivë të sigurisë ekonomike, sociale dhe kulturore.”⁹¹

Për mendimin tim, LKM-ja mund të shërbejë si një masë efektive e ndërtimit të besimit në këtë kohë tranzicioni për Kosovën. Zbatimi i plotë i ligjit do të mundësonte marrëdhëniet mes komuniteteve të ndryshme dhe do të përforconte procesin e suksesshëm të ndërtimit të paqes. Shihet qartë që “Arsimi dhe Mësimi për të Drejtat e Njeriut është instrument i fuqishëm (...) në proceset e transformimit dhe konsolidimit pas konfliktit”, prandaj, “strategjitë e parandalimit të konfliktit dhe rehabilitimit pas konfliktit duhet të ndërtohen si pjesë përbërëse e strategjive të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.”⁹² Kështu, LKM-ja mund të shërbejë jo vetëm si pjesë e mirë e legjislacionit, por edhe si instrument i arritjes së stabilitetit në Kosovë, sidomos kur kemi parasysh sfidat e ardhme që na presin. Për këtë arsye, është imperativ trajtimi i problemeve të zbatimit të tij, për ta bërë atë të afërt për qasjen e banorëve të Kosovës.

⁸⁹ Propozimi Gjithëpërfshirës për Statusin, neni 2 (2.3.), f. 19 (versioni anglisht).

⁹⁰ Ligji nr. 2004/3, neni 2 (c).

⁹¹ Benedek, Wolfgang (2005) “Statusi Përfundimtar i Kosovës: Roli i të Drejtave të Njeriut Njerëzore dhe të Drejtave të Pakicave, (Final Status of Kosovo: The Role of Human Rights and Minority Rights)”, në “Chicago-Kent Law Review”, f. 232; në dispozicion në faqen <http://lawreview.kentlaw.edu/articles/80-1/Benedek%20PDF3.pdf>.

⁹² Rrjeti i Sigurisë Njerëzore, Deklarata e Gracit mbi Parimet e Edukimit për të Drejtat e Njeriut dhe Sigurisë Njerëzore (Human Security Network, Graz Declaration on Principles of Human Rights Education and Human Security) (8-10 Maj 2003), Pika 2; në dispozicion http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/human_security/declaration.pdf.

Vështrim mbi implementimin e ligjit Kundër Diskriminimit – Këndvështrimi Serb⁹³

Milica V. Matijević MA⁹⁴

Hyrje

Më 19 shtator 2004, pas më shumë se një viti pune përgatitore, Kosova është bërë shoqëri me njërin nga ligjet më të avancuara kundër diskriminimit në Evropë.⁹⁵ Ligji i Kosovës kundër diskriminimit (në tekstin e mëtutjeshëm LKD) parasheh ndalimin e pakufizuar të të gjitha formave të diskriminimit; ofron mbrojtje ligjore kundër sjelljeve diskriminuuese nga organet publike si dhe organizatat private dhe individët; përdallim nga modelet e Bashkimit Evropian të cilat janë të kufizuara në përmbajtjen e tyre⁹⁶, ndalon diskriminim në qasjen në, dhe gëzimin e *çdo të drejte* të përcaktuar me ligjet në fuqi në Kosovë; ofron mbrojtje të veçantë për komunitetet joshumicë; fut në përdorim masa të veprimeve pozitive⁹⁷; dhe në fund, LKD siguron një sistem të sofistikuar të ndëshkimeve për shkeljet e dispozitave të saj. Por, pyetja është se sa nga këto “të drejta në letër” janë zbatuar deri më tani⁹⁸?

Sipas botuesve të këtij publikimi, ky koment do të shërbejë si vështrim ndaj “këndvështrimit serb” për zbatimin e LKD-së. Meqë është detyrë e vështirë të flasim në emër të një komuniteti etnik në një shoqëri ku diskriminimi etnik është vetëm njëra nga shumë forma të identifikuar të diskriminimit, synimi im më shumë do të jetë që të qëndroj brenda kufijve të vështrimit personal ndaj temës në fjalë. Një ton jashtëzakonisht personal, prezent në tërë tekstin, është vënë për të përkujtuar faktin se vërejtjet e shpalosura vijnë nga një vëzhgues serbfolës, dhe autori të falet për kufizimet gjuhësore si dhe saktësinë e informatave në të cilat bazohet ky dokument.

Disa vërejtje themelore

Është e vështirë të fillosh të analizosh implementimin e një teksti kaq të avancuar ligjor siç është ai i LKD-së në Kosovën e sotme. Ligji përmban një varg normash ligjore të dizajnuara për të mbrojtur një individ kundër formave shumë të sofistikuar të diskriminimit. Në të njëjtën kohë, raste të diskriminimit të drejtpërdrejtë ngjajnë rregullisht para syve tanë duke vënë në pikëpyetje vetë domethënien e diskutimit akademik të këtij lloji. Më lejoni ta shtjelloj këtë:

⁹³ Ky dokument është përmbledhje e një analize të botuar së fundi nga Iniciativa Rinore për të Drejta të Njeriut (IRDNJ) si pjesë e një studimi më të gjerë mbi zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë. Shih: Iniciativa Rinore për të Drejta të Njeriut. 2007. “Raporti mbi Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit”, Prishtinë.

⁹⁴ Milica V. Matijević është hulumtuuese e pavarur në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Beogradit dhe ka magjistruar në të drejtat e njeriut dhe demokratizim (E.MA) në Qendrën Ndëruniversitare Evropiane (QNUe) në Venedik (Itali). Gjatë tri viteve të fundit ajo është angazhuar në masë të madhe në përkrahjen dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në Kosovë.

⁹⁵ Ligji Kundër Diskriminimit nr. 2004/32 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32 për shpalljen e ligjit kundër diskriminimit, të datës 20 gusht të vitit 2004.

⁹⁶ Urdhëresa e Këshillit Evropian 2000/43/EC e cila zbaton parimin e trajtimit të barabartë në mes të personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike (botuar në OJ L 180 më 19 korrik të vitit 2000) dhe Urdhëresa e Këshillit të Evropës 2000/78/EC e cila përcakton korvizën e përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (botuar në OJ L303 më 2 dhjetor të vitit 2000).

⁹⁷ Ndonëse dispozitat e masave të veprimeve pozitive të LKD-së janë tejet të avancuara dhe të shkruara në pajtim me standardet më të larta të BE-së, ligjvënësi ka lënë jashtë rregullimin e parimit të akomodimit të arsyeshëm në rast të diskriminimit në bazë të paaftësive të personit.

⁹⁸ Shprehja është marrë nga Raporti i Grupit ndërkombëtar për të drejta të pakicave në Kosovë ku kjo shprehje shfrytëzohet për të përshkruar një situatë ku “pakicave u ofrohet në rastin më të mirë një varg të drejtash në letër, pa asnjë masë efektive të zbatimit”. Në: Clive Baldëin, *të Drejtat e pakicave në Kosovë sipas rregullit ndërkombëtar*, Grupi ndërkombëtar për të drejta të pakicave, Londër, 2006, f. 25.

Duke qenë vetë avokate e të drejtave të njeriut, unë emocionohem secilën herë që i lexoj dispozitat e këtij ligji të shkëlqyeshëm, dhe po aq dekurajohem duke i lexuar apo duke tentuar ta lexoj urdhëresën përmes së cilës LKD duhet të zbatohet. Gabimet drejtshkrimore dhe terminologjike që mund t'i gjesh në versionin serb të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2006 mbi Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (në tekstin e mëtuftjeshëm Udhëzimi)⁹⁹ janë aq të shumta sa që, i bën të kota përpjekjet për të kuptuar kuptimin e këtij teksti.¹⁰⁰ E njëjta vlen për Udhëzimin e sapo miratuar Administrativ nr. 04/2007 mbi Njësitë e të drejtave të njeriut në Qeverinë e Kosovës e cila është menduar të shërbejë si një hap drejt zbatimit të LKD-së.

Qoftë për shkak të mungesës së burimeve, apo për shkak të neglizhencës së madhe për dispozitat që rregullojnë përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë¹⁰¹, fakti qëndron se kjo mospërfillje, jo vetëm që diskriminon, por edhe seriozisht ndikon në të drejtën e personave joshqiptar në Kosovë për të mësuar mbi të drejtat dhe obligimet e tyre sipas këtij sistemi ligjor. Këtu, dua të rikujtoj se sipas standardeve të përcaktuara me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të qenë i ligjshëm, një akt ligjor ai duhet të ketë *cilësi adekuate*, e cila pikësepari nënkupton se duhet të jetë i *qasshëm* dhe i *parashikueshëm*¹⁰².

Zbatimi dhe aplikimi LKD-së

Mungesa e ligjshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 04/2006 tregon se pavarësisht nga përgatitjet e ndërlikuara dhe të gjata, sot, pothuajse tri vite pas miratimit të tij, procesi i zbatimit të LKD-së është akoma gati në të fillim. Janë tri argumente të cilat do t'i përdorë për ta demonstruar këtë deklaratë. Së pari, ekziston një konfuzion në lidhje me organet që janë të ngarkuara apo përndryshe të përfshira në zbatimin e ligjit. Së dyti, mbrojtja e plotë ligjore e ofruar nga dispozitat e këtij ligji për viktimat e diskriminimit nuk është përcjellë si duhet nga ana e mekanizmave adekuat të zbatimit. Së treti, strategjitë për luftimin e diskriminimit të tërthortë dhe të sigurimit të përfaqësimit të drejtë të komuniteteve në Kosovë si rregull i përgjithshëm kanë mungesë të një baze të qartë statistikore që shpeshherë përfundon si mjet tejet joefektive.

a) Organet për zbatimin e LKD-së

Përkundër faktit se LKD i takon grupit të ligjeve të cilat kërkojnë një infrastrukturë të konsiderueshme institucionale për t'u bërë *de facto* të zbatueshëm, ekziston një mungesë e dukshme e qartësisë lidhur mbi atë se cili organ apo cilat organe janë në krye të zbatimit të tij.

Një pjesë e madhe e kësaj situatë mund t'i atribuohet vetë dispozitave të paqarta të dy kapitujve të fundit

⁹⁹ Udhëzimi administrativ nr. 04/2006 mbi Zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit i datës 25 maj 2006. Meqë në kohën e miratimit të Udhëzimit, versioni i gjuhës angleze kishte të njëjtën vlefshmëri ligjore sikurse versionet e gjuhës shqipe dhe serbe, analiza do të krahasojë të tri gjuhët e Udhëzimit në mënyrë që të mësojë për përmbajtjen e tij.

¹⁰⁰ Jo vetëm që Udhëzimi në fjalë përmban shifra të pafundme të gabimeve në shtyp dhe gramatikë, por gjithashtu ka mospërpjetë të konsiderueshme në mes të versioneve të gjuhëve të ndryshme të tekstit të Udhëzimit. Për ilustrim më të hollësishëm të kësaj, ju lutem shikojeni: "Raportin e Zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit", të Iniciativës Rinore për të Drejtat e Njeriut të vitit 2007, Prishtinë. Kjo megjithatë, nuk është hera e parë që 'fati' ligjor i i LKD-së konfrontohet me këso lloj problemesh. Për shembull, LKD do të ishte miratuar shumë më herët nëse, para votimit të tij të parë në shkurt të vitit 2004, nuk do të kundërshtohej nga deputetët serbë për shkak të përkthimit të shtrembëruar në gjuhën serbe. Shih: Buletinin e Iniciativës së OSBE-së për përkrahje për Kuvendin Sabovic, S., Steinle, U., 'I humber në përkthim' apo Si t'i bëjmë tri gjuhët të flasin në një zë ligjor, Edicioni i veçantë, nr. 15, Prishtinë, shkurt, 2005.

¹⁰¹ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-37 mbi Përdorimin e gjuhëve i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51 mbi Shpalljen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve të 20 tetorit 2006.

¹⁰² Shih për shembull, *Sunday Times kundër Britanisë së Madhe* ([1979-80] 2 EHRR 245, 26 prill 1979) apo lëndët që përfshijnë cilësinë e mjeteve juridike në vend siç janë *Akdivar dhe Tjerët kundër Turqisë* (aktgjykimi i 16 shtatorit të vitit 1996, Raportet e Aktgjykimeve dhe vendimeve 1996-IV, p. 1210, § 67), *Andronicou dhe Constantinou kundër Qipros* (aktgjykimi i 9 tetorit të vitit 1997, Raportet 1997-VI, pp. 2094-95, § 159), *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, (71503/01 [2004] ECHR 140 (8 prill 2004), § 127), etj.

të LKD-së. Në kapitullin III, nën titullin “*Organet për promovimin e trajtimit të barabartë* (fjala në stilin italik është shtuar)”, ligjvënësi i referohet vetëm një organi – Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë. Në të vërtetë, ky Kapitull vetëm sa konfirmon rolin e Institucionit të Ombudspersonit si organi i autorizuar “për të pranuar dhe hetuar ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave në bazë të diskriminimit” në pajtim me kreun 10 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme¹⁰³ dhe Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2000/38¹⁰⁴. Megjithatë, leximi i kujdesshëm i kreut të mëhershëm (neni 9(5)) të LKD-së, përcakton më shumë se një organ për t’u themeluar me këtë ligj – Qendra për Trajtim të Barabartë:

“Mjetet e grumbulluara nga gjocat e parapara nën 9.2 b, do të administrohen nga një organ i caktuar administrativ apo gjyqësor, deri në themelimin e Qendrës për Trajtim të Barabartë.”

Sidoqoftë, ky organ nuk rregullohet më tutje në asnjë dispozitë në vijim të LKD-së dhe as në Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e LKD-së, që do të mund të çonte në konkluzionin se dispozita që i referohet Qendrës për Trajtim të Barabartë është vetëm rezultat i një lëshimi që ka ndodhur gjatë fazës së hartimit. Në të vërtetë, Qendra për Trajtim të Barabartë si organ kryesor për zbatimin e LKD-së ka qenë një zgjidhje e propozuar në projektin e fundit të LKD-së, dhe pas kritikave të shprehura, mes tjerash, nga ana e Ombudspersonit në Kosovë, është lënë jashtë versionit përfundimtar të Ligjit.¹⁰⁵

Ndonëse është pritur shumë, Udhëzimi Administrativ për zbatimin e LKD-së i muajt maj 2006 nuk e zgjidhi këtë problem në mënyrë gjithëpërfshirëse apo të prekshme. Ndonëse, sipas nenit 1, “qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vendosja e rregullave praktike, lehtësimeve strukturore dhe fizike për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit [...]”¹⁰⁶ Udhëzimi nuk përmbush synimin e vetëpërcaktuar. Në fakt, dispozita e vetme në Udhëzim që prek këtë çështje është ajo e nenit 6, e cila obligon Zyrën për qeverisje të mirë “që të përgatit, publikojë dhe shumëzojë” informatat e institucioneve dhe organeve përgjegjëse për pranimin, gjykimin dhe përndryshe reagimin mbi parashtrimet që tregojnë shkelje të LKD-së. Megjithatë, neni 6 nuk specifikon në vete asnjërin nga këto organe apo procedura. Por përsëri, ndonëse Udhëzimi është nxjerrë para pothuajse një viti, deri më sot autori i këtij dokumenti nuk ia arriti të identifikojë asnjë akt të nxjerrë nga Zyra për qeverisje të mirë për përmbushjen e këtij synimi.

Veç kësaj, nuk është e qartë pse baza institucionale për zbatimin dhe aplikimin e këtij ligji nuk përfshin instrumentet tanimë ekzistuese për ndërmjetësim dhe pajtim, të themeluara në nivel lokal – zyrtarët për ndërmjetësim dhe komunitete tanimë të rregulluar në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45¹⁰⁷ të vitit 2000. Kjo nuk do t’i ofronte vetëm një mekanizëm më të qasshëm për të akomoduar ankesat e mundshme banorëve të komuniteteve që i përkasin të njëjtës pakicë etnike, fetare apo gjuhësore por gjithashtu do të mund të

¹⁰³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë, e 15 majit të vitit 2001.

¹⁰⁴ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë e 30 qershorit të vitit ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/7 të 14 prillit të vitit 2003.

¹⁰⁵ Do të thotë, Ombudspersoni në Kosovë me të drejtë kishte theksuar se “duke i dhuruar Qendrës këto kompetenca që do të dyfishonin ato të Institucionit të Ombudspersonit nuk do të ishte në përfitim të synimit të përbashkët të promovimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë”. Për më tepër shih: ëëë.ombudspersonkosovo.org

¹⁰⁶ Një mangësi tjetër serioze e Udhëzimit është se ajo përfshin një citim të papërfunduar dhe ndryshuar të bazës së diskriminimit që gjendet në nenin 2(a) të Ligjit Kundër Diskriminimit, duke shtrembëruar kështu rregullin themelor të ligjit që duhet të implementojë.

¹⁰⁷ Neni 23 Rregulloreve të UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, e 11 gushtit të vitit 2000 dhe Udhëzimi administrativ i UNMIK-ut 2003/002 mbi Udhëzimet procedurale për komitetet komunale të komuniteteve e 15 shtatorit të vitit 2003 dhe UA 2005/001 mbi Udhëzimet procedurale për komitetet komunale të ndërmjetësimit e 13 prillit 2005.

fuqizonte këto komisione, funksioni i të cilave është, sipas studimit më të fundit, i dëmtuar seriozisht nga një numër i pengesave.¹⁰⁸ Kjo do të mund të dëshmohej të jetë më e dobishme, meqë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë në mes të Njësisë së sapo themeluar të Drejtave të Njeriut brenda Ministrive të Qeverisë së Kosovës dhe organeve në nivelin komunal.¹⁰⁹

b) Zbatim i LKD-së

Ndonëse, na pajtim me trendet moderne ligjore, LKD në masë të madhe e zvogëlon pozitën e viktimës së diskriminimit, dhe synon të ndërmer veprim ligjor duke bartur barrën e provave, pothuajse nuk ekziston asnjë rast i thirrjes në dispozitat e tij në gjykatat në Kosovë.¹¹⁰ Përderisa është e vërtetë se zbatim i një zgjidhjeje të tillë ligjore revolucionare është dëshmuar se është proces që shpenzon shumë kohë madje edhe për shoqëritë me sisteme shume më të qëndrueshme ligjore, mangësi të caktuara në sistemin ligjor në Kosovë imponojnë kufizime shtesë në zbatimin e ligjit. Krahas situatës kritike të gjyqësorit të Kosovës i cili po vuan nga një ngarkesë e jashtëzakonshme e lëndëve¹¹¹, mungesa e një sistemi të ndihmës juridike, informimit publik dhe fushatës së avokimit është ana tjetër e këtij problemi.

Ndihma juridike pa pagesë

E veçanta e LKD-së është dispozita e vendosur në kapitullin II e cila rregullon sistemin e sanksionimit. Në nenin 9(4) ligjvënësi përcakton se të gjitha paratë e grumbulluara përmes shqiptimit të gjobave “do të vendosen në një fond i cili do të themelohet për qëllim të ofrimit të ndihmës juridike” për ata persona të drejtat e të cilëve janë shkelur. Meqë dispozita në fjalë, deri më sot, ka mbetur vetëm si një “e drejtë në letër”, manifestimi i mungesës së ndihmës juridike mund të shihet në të njëjtën kohë si shkaku dhe pasoja e mos-zbatimit të LKD-së.

Fushatat e vetëdijesimit të publikut

Zbatim i LKD-së është keqësuar edhe më tej nga një mungesë e përgjithshme e përvojës së shërbyesve civil mbi praktikat kundër diskriminimit dhe mungesës së vetëdijes mbi fushëveprimin e mbrojtjes së ofruar nga ky ligj për banorët e Kosovës në përgjithësi. Fushatat e ardhshme të informimit publik për të drejtat e garantuara në LKD duhet të shkojnë shumë më tej se sa thjeshtë prodhimi dhe shpërndarja e broshurave, fletëpalosjeve dhe afisheve. Për këtë gjë, një përqëndrim më i fuqishëm mbi zhvillimin e kapacitetit të shoqërisë civile në Kosovë për promovimin e praktikave kundër diskriminimit do të jetë njëra nga prioritetet. Kjo vlen edhe më shumë kur kemi para sysh se “[a]sociacionet, organizatat apo subjektet tjera ligjore mund të krijojnë apo përkrahin veprime juridike në emër të paditësit apo paditësve, me pëlqimin e tyre”¹¹², dhe në këtë mënyrë do të kenë një rol më të rëndësishëm në zbatimin e këtij ligji.

¹⁰⁸ Studimi i kryer bashkërisht mes Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Zyrës së UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe marrëdhënie me pakica (ZKKP) mbi funksionimin e komitetit për komunitete dhe atij për ndërmjetësim. Shih: Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, *Raporti i dorëzuar i Komisioni për të Drejta të Njeriut mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë që nga qershori 1999*, shkurt 2006, f. 49.

¹⁰⁹ Dispozita e vetme e Udhëzimit administrativ nr. 04/2007 mbi Njësinë për të drejta të njeriut në Qeverinë e Kosovës e cila i referohet organeve të nivelit lokal është neni 12(2) ku thuhet se “ZKM/ZKQM koordinon komunikimin e NjDNj-së me agjencitë relevante vendore dhe ndërkombëtare që merren me çështjet e të drejtave të njeriut dhe të cilat me pëlqimin e Qeverisë janë të angazhuara në bashkëpunim në ofrimin e ndihmës profesionale për projektet e të drejtave të njeriut.”

¹¹⁰ Ndryshe nga lëndët civile ku çdo paditës duhet të mbajë mbi vete barrën e sigurimit të provave që ai apo ajo do të paraqesin gjatë paraqitjes së rastit të tyre, në vitet e fundit është futur në përdorim një rregull i veçantë për “bartjen e barrës së provave” në rastet e diskriminimit në gjykatat e BE-së dhe organet e traktateve të OKB-së. Në pajtim me trendet aktuale, në nenin 8 LKD po ashtu bartë barrën e provave në rastet e diskriminimit.

¹¹¹ Për më tepër shih: Misioni i OSBE-së në Kosovë – Njësitë për monitorimin e sistemit ligjor, *Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile në Kosovë*, qershor, 2006.

¹¹² Neni 7(6) i LKD-së.

c) Barazia si rezultat – strategjitë kundër diskriminimit në Kosovë

Masat e veprimit pozitiv

Barazia nuk është vetëm trajtimi i barabartë i të barabartëve por edhe trajtimi i pabarabartë i të pabarabartëve në raport me pabarazinë e njerëzve.¹¹³ Zbatimi i parimit të barazisë, si parimi kryesor i LKD-së, nuk kërkon vetëm obligime negative siç janë detyrimi për t'u përmbajtur nga sjellja diskriminuese. Ndalimi i diskriminimit të tërthortë, i cili përqendrohet në barazinë si rezultat, gjithashtu vendos një obligim pozitiv si ndaj agjentëve privat ashtu edhe atyre publik. Prandaj, në paragrafin e dytë të nenit 6 ligjvënësi parasheh një masë të veçantë të veprimit pozitiv:

“Të gjithë personat që ushtrojnë funksione publike duhet të sigurojnë që palët të cilave u japin kontratën publike, huan, grantin, ose ndonjë përfitim tjetër do të nënshkruajnë një dokument i cili tregon se ata do të veprojnë në pajtim me këtë ligj, dhe se të promovojnë dhe respektojnë politikën e mosdiskriminimit gjatë tërë kohës së ekzekutimit të detyrimeve”¹¹⁴

Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme nëse lexohet së bashku me nenin 3(b) (ndalimin e diskriminimit të tërthortë)¹¹⁵ dhe nenin 4(a) të LKD-së (ndalimi i diskriminimit në qasjen në punësim)¹¹⁶. Ndonëse varfëria dhe shkalla e lartë e papunësisë prekin shumicën e popullatës në Kosovë, “komunitetet pakicë dhe veçanërisht grupet e cenushme janë posaçërisht të prekura në një mënyrë joproporcionale”¹¹⁷. Prandaj, nëse zbatohet dispozita në fjalë mund të zvogëlohet niveli i diskriminimit në fushën e punësimit.

Përkundër kësaj, ka indikacione që deri më sot nuk ka ndodhur asnjë rast ku një deklaram i këtij lloji u është bashkangjitur dhënies së kontratës publike, grantit, huadhënies apo ndonjë përfitimi tjetër. Pavarësisht se cili institucion apo organ ka qenë në krye të zbatimit të dispozitës në fjalë - institucioni i përkohshëm i vetëqeverisjes apo institucionet ndërkombëtare që ushtrojnë funksion kuazi-shtetëror në Kosovë.

Strategjitë e përfaqësimit të drejtë të komuniteteve dhe mungesa e të dhënave

Si zgjatje simbolike e ndalimit të diskriminimit të tërthortë, “parimi i përfaqësimit të drejtë të gjithë personave dhe pjesëtarëve të komuniteteve në punësim brenda organeve publike” është bërë një nga tri parimet kryesore në të cilët mbështetet LKD.¹¹⁸ Megjithatë, ekzistojnë dy pengesa kryesore në operacionalizimin

¹¹³ Ky parim është i shprehur qysh në dispozitën e parë të LKD-së (neni 1) që përcakton se: “Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, promovimi i barazisë efektive dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit.”

¹¹⁴ Veç kësaj, për të përfuruar këtë dispozitë, në paragrafin e fundit të të njëjtit nen, LKD thekson se, nëse pala e cila pranon kontratë publike, hua, kontribut financiar ose përfitime tjera të përmendura në nenin 6.2, shkel cilëndo nga dispozitat e këtij ligji, kontrata publike, hua, kontribut financiar ose përfitimet tjera, shpallen të pavlefshme nëse shkelen dispozitat e këtij paragrafi.

¹¹⁵ Neni 3(b) i LKD-së thotë: “Diskriminimi i tërthortë nënkuptohet kur nga bazat e përshkruara nën 2 a, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e ven personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerë, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat që e ndalojnë diskriminim, përveç në rastet kur dispozita e tillë, praktika apo kriteri mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të domosdoshme për arritjen e qëllimit.”

¹¹⁶ Neni 4(a) i LKD-së tregon thotë: “Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, në fushat si vijon: (a) kushteve për qasje në punësim, vetëpunësim dhe në punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit dhe kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysht aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale dhe avancimit .”

¹¹⁷ Shtojca e Dokumentit e 7 tetorit të vitit 2005 e Sekretarit të Përgjithshëm e drejtuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit – Rishikimi gjithëpërfshirës mbi situatën në Kosovë (i ashtuquajtur ‘Raporti i Kai Eide), faqe 11.

¹¹⁸ Neni 2(b) i LKD-së.

e këtij parimi. Së pari, “vlerësimi i shtrirjes së diskriminimit ndaj grave, fëmijëve, pakicave, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve tjera të cenueshme, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, është i vështirë për t’u kryer për shkak të mungesës së të dhënave”.¹¹⁹ Së dyti, pa të dhëna të besueshme është vështirë të mendohet për ndonjë strategji efektive për të luftuar *de facto* pabarazitë që ekzistojnë në shoqërinë Kosovare. Fatkeqësisht, kjo tanimë është dëshmuar në rastin e Strategjisë së vitit 2002 për themelimin e përfaqësimit proporcional të komuniteteve.¹²⁰ Siç është pranuar nga UNMIK-u, si nismëtar kryesor i tij, asnjë element i vetëm i tij nuk është implementuar deri më sot.¹²¹ Siç tregon Kai Eide në Rishikimin gjithëpërfshirës mbi situatën në Kosovë, punësimi i pakicave “shpeshherë shihet si çështje e përmbushjes së kuotës sesa sigurim i pjesëmarrjes domethënëse”.¹²²

Të dhënat statistikore janë po aq të rëndësishme në kuptim të dispozitës së nenit 8(2) ku ligjvënësi sqaron se “paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore”.

Konkludim

Kosova është një shoqëri ku ndarja në vija etnike është ende shumë e theksuar. Prandaj, autori i këtij punimi beson se pa pasur programe të pajtimit të zhvilluara mirë dhe të realizuara me durim në Kosovë nuk do të ketë ballafaqim të suksesshëm me praktikatat diskriminuese.¹²³ Pajtimi është koncepti bazë i politikave kundër diskriminimit i përfshirë në LKD, meqë “parimi i mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të banorëve të Kosovës” janë në mesin e parimeve themelore të tij.¹²⁴

Rekomandime:

1. Lufta ndaj diskriminimit gjuhësor – Institucionet e Përhohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ) duhet të sigurojnë, si çështje urgjente, mjete të duhura për përkthim kualitativ dhe me kohë të të gjitha dokumenteve publike në gjuhën serbe në të gjitha nivelet.
2. **Fuqizimi i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë** – Duke qenë se roli i spikatur në zbatimin e dispozitave të LKD-së i është caktuar Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, dhe meqë ky institucion është mjaft mirë i vendosur në mesin e anëtarëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë, kapacitetet e këtij institucioni duhet të përforcohen edhe më tej, në veçanti përmes forcimit të burimeve njerëzore të tij.
3. **Fushata për vetëdijesimin e publikut** - Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së bashku me ndihmën e organizatave ndërkombëtare në Kosovë, duhet të planifikojnë dhe realizojnë në mënyrë sistematike një fushatë intensive të vetëdijesimit të publikut në lidhje me LKD-në. Grupi i synuar i fushatës për LKD-në duhet të jetë popullata e përgjithshme e Kosovës, me përqendrim të veçantë në a) anëtarët e komuniteteve veçanërisht të cenueshme, b) anëtarët e shërbimit civil të Kosovës, në të gjitha nivelet, c) studentëve, d) përfaqësuesve të shoqërisë civile në Kosovë.

¹¹⁹ Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Raporti mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut në Kosovë i shkurtit 2006, që i është dorëzuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut që nga viti 1999, f. 41.

¹²⁰ Po aty, f. 43 – 44.

¹²¹ Po aty.

¹²² Shtojca e letrës së Sekretarit të Përgjithshëm e 7 tetorit 2005, që i drejtohet Kryesuesit të Këshillit të Sigurimit – Shqyrtimi gjithëpërfshirës i situatës në Kosovë (i ashtuquajtur “Raporti i Kai Eides”), f. 10.

¹²³ Shih, për shembull, gjetjet e hulumtimit mbi ndikimin e aktiviteteve të ndërtimit të paqes në Kosovë, të kryer nga CDA- “Projektet e Mësimi për Bashkëpunim”. *Çfarë ndryshimi ka sjellë ndërtimi i paqes? Studim mbi efikasitetin e ndërtimit të paqes në parandalimin e dhunës: mësimet e nxjerra nga trazirat e marsit 2004 në Kosovë*, Kembrixh, MA, 2006.

¹²⁴ Neni 2(c) i LKD.

4. **Forcimi i shoqërisë civile** – Duhet të ketë përpjekje të posaçme nga ana e komunitetit ndërkombëtar të donatorëve në Kosovë për ngritjen dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të OJQ-ve në Kosovë, të cilat avokojnë mosdiskriminim dhe praktikat që për kanë për bazë barazinë.
5. **Mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave** – Institucionet e përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë duhet të bëjnë përpjekje të mëtejshme në mbledhjen dhe themelimin e bazave të të dhënave të sakta dhe të besueshme mbi aspekte të ndryshme të praktikave diskriminuese në Kosovë.
6. **Programet e pajtimit** – Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë duhet të bëjnë shumë më tepër përpjekje për zhvillimin dhe realizimin e një strategjie të pajtimit mbarë-kosovar.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

“Tryeza e rrumbullakët mbi zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit” u mbajt më 18 prill 2007, organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK). Synimi i tryezës ishte të shërbejë si forum për dialogun mbi zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (LKD) si dhe për të ngritur vetëdijen mbi zbatimin e tij te bartësit e ndryshëm të procesit.

Z. Hilmi Jashari theksoi që roli i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë (IOK) është plotësues në zbatimin e LKD-së nga gjykatat. IOK shërben si ndërmjetës mes autoriteteve publike dhe qytetarëve, ndërsa procedurat e tij janë më pak formale dhe më të shpejta sesa ato gjyqësore, duke ofruar shërbime pa pagesë. Për më shumë, IOK-ja mund të hapë hetime *ex officio* (sipas detyres zyrtare) nëse ka informata nga burime të ndryshme që ka ndodhur ndonjë shkelje. Z. Jashari theksoi që vetëdija brenda shoqërisë kosovare mbi parimin e diskriminimit dhe luftimit kundër tij është ende e dobët.

Z. Habit Hajredini theksoi që prioritet i Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit (ZQM/ZKM) është ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të lartë në nivelin qendror si dhe kapaciteteve të zyrtarëve të lartë komunalë të cilët kanë ndikim, apo luajnë rol thelbësor në zvogëlimin e rasteve të diskriminimit gjatë ushtrimit të obligimeve të tyre ligjore. ZQM/ZKM lansoi Fushatën e Informimit Publik për LKD-në për të rritur vetëdijen mbi LKD-në dhe mbi të drejtat që i garanton. Fushata përfshinte shpërndarjen e materialeve, posterëve dhe broshurave në pesë gjuhë, në gjitha institucionet kosovare, në nivelin qendror dhe lokal. Rrethi i parë i fushatës së LKD-së u përmyll me sukses dhe tani ZQM/ZKM është në procesin e organizimit të rrethit të dytë të fushatës.

Dr. Melissa Stone theksoi që në Kosovë, LKD-ja në themel rridefinon identitetin e personave. Vetëm disa vite më herët, kishte disa përkufizime të ndryshme të përkatësisë kombëtare, shtetësisë dhe statusit të lindjes në Kosovë. Varësisht nga kombinimet e këtyre faktorëve, njerëzit me identitete të ndryshme kishin privilegje e përfitime të ndryshme. Dr. Stone paraqiti informata të reja shkencore mbi kryqëzimet mes identitetit kulturor dhe gjenetik, si dhe mënyrën se si kjo na bën të vëmë në pyetje definimet e mëhershme të identitetit. Ajo ishte e bindur, se çështjet që dalin nga zbatimi i LKD-së do të çojnë drejt thellimit të një diskutimi politik rreth asaj se sa të ndryshëm jemi prej njëri tjetrit, dhe sa jemi të njëjtë, dhe meritojmë të njëjtat të drejta të njeriut.

Z. Lavdim Krasniqi theksoi që synimi i Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGjK) është të ngrisë profesionalizmin e gjykatësve dhe prokurorëve duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e punës së tyre. Qysh prej krijimit, IGjK-ja ka trajnuar gjykatës e prokurorë, si dhe publikon buletine mujore dhe materiale të ndryshme në të tri gjuhët zyrtare. IGjK-ja tanimë ka përgatitur dhe ka afatizuar trajnimet (qershor dhe tetor 2007) për gjykatës dhe prokurorë në zbatimin e LKD-së. Z. Krasniqi theksoi që ka mungesë të buxhetit për IGjK-së, gjë që paraqet një pengesë për vazhdimin e aktiviteteve të IGjK-së në lidhje me zbatimin e LKD-së.

Znj. Polina Roussinova foli mbi atë që OJQ-të për të drejtat e njeriut mund të bëjnë më konkretisht në zbatimin e LKD-së dhe shpjegoi veprimet/hapat në vijim, të cilët janë treguar të suksesshëm në Bullgari në këtë aspekt: *rastet strategjike gjyqësore* (sjellja e rasteve strategjike të cilat ilustrojnë problemet strukturore apo të shpeshta të cilat prekin një numër individësh në gjithë shoqërinë); *ngritja e procedurave të orientuara kah klienti* (të cilat janë të përqendruara vetëm te klienti, përmes ndihmës juridike, vetë-inicimit të rasteve pa lejen e viktimës, ose në emër të viktimës); *hulumtimi dhe monitorimi* i praktikave diskriminuese (raportimi publik, lobimi dhe avokimi përmes mediave, si dhe trajnimi mbi LKD-në).

Znj. Arjeta Rexhaj theksoi që mbetet shumë për t'u bërë drejt zbatimit të LKD-së. Znj. Rexhaj deklaroi që femrat në Kosovë janë gati të përjashtuara nga procesi i vendimmarrjes, ndërsa të drejtat e tyre shkelen

jo vetëm nga institucionet publike, por edhe në shtëpi. Qendra për Trajnim dhe Huluntim (TRC) ka luajtur rol të konsiderueshëm në edukimin për të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes, përmes organizimit të trajnimeve, ligjëratave, konferencave, tryezave të rrumbullakëta, si dhe debateve mbi të drejtat e njeriut. Znj. Rexhaj rekomandoj që shoqëria civile duhet të angazhohet në procesin e hartimit të legjislationit si dhe ka nevojë të përfshihet më shumë në ngritjen e vetëdijes.

Z. Nenad Rikalo theksoi, që tani është koha të fillohet ndërtimi i partneritetit me institucionet qeveritare në mënyrë që të krijohen mundësi për zbatimin e suksesshëm të LKD-së. Ekzistojnë katër segmente në të cilat shoqëria civile mund të luajnë rol aktiv në zbatimin e LKD-së: *Informimi* (është e dukshme që mungon informimi te popullata në Kosovë në lidhje me LKD-në), *Promovimi* (ekzistojnë mënyra të ndryshme në të cilat shoqëria civile mund të promovojë LKD-në dhe të gjitha aspektet e tij pozitive), *Paraqitja* (shoqëria civile dhe institucionet qeveritare duhet të paraqesin atë çka mundet dhe çka duhet bërë) dhe *Presioni* (shoqëria civile mund të ndërmarrë veprimtari të ndryshme për të rritur presionin mbi institucionet qeveritare, p.sh. debatet, tryezat e rrumbullakëta dhe ekspozimi në media).

Z. Osman Osmani theksoi që pozita e fëmijëve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas (RAE) është shumë e vështirë. Fëmijët e këtyre komuniteteve në përgjithësi janë jashtë shkollave, duke u prirur më shumë drejt kërkimit të lëmshës në rrugë dhe ekspozimit ndaj punëve të rënda. Ai më tutje theksoi që ekzistojnë shumë përpjekje nga IPVQ-të dhe organizatat e ndryshme vendore e ndërkombëtare për të ndihmuar dhe përmirësuar kushtet e jetës së komunitetit RAE dhe fëmijëve në veçanti, por gjendja ende mbetet e vështirë. Z. Osmani shprehu gatishmërinë e komunitetit të tij të bashkëpunojë në përmirësimin e zbatimit të LKD-së.

Mundësitë/Rekomandimet:

- *Qeveria e Kosovës dhe akterët tjerë gjegjësis duhet që çështjen e zbatimit të LKD-së ta bëjnë prioritet;*
- *Hartimi i politikave dhe programeve të qarta për zbatimin e LKD-së;*
- *Vazhdimi i fushatave të ngritjes së vetëdijes së opinionit publik;*
- *Më shumë trajnime për gjykatës e avokatë mbi LKD-në;*
- *Avancimi i bashkëpunimit në mes të akterëve të ndryshëm, kryesisht mes institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile;*
- *Përfshirja e sektorit privat në përpjekjet për promovimin e LKD-së;*
- *Rritja e përfshirjes së OJQ-ve në zbatimin e LKD-së me raste strategjike, rastet të orientuara kah klienti dhe huluntim e monitorim i rasteve të diskriminimit;*
- *Më shumë debate, tryeza të rrumbullakëta dhe ekspozim në media të çështjeve që kanë të bëjnë me LKD-së;*
- *Përfshirje më e madhe e shoqërisë civile në procesin legjislativ;*
- *Rritja e vetëdijes mbi LKD-në në qarqet akademike.*

Implementimi i Ligjit Kundër Diskriminimit

Raport mbi Tryezën e Rrumbullakët më 18 prill 2007, Prishtinë/Priština

Nga Remzije Istrefi¹²⁵

1. Hyrje

“Tryeza e rrumbullakët mbi implementimin e Ligjit kundër diskriminimit” është mbajtur më 18 prill 2007, dhe ajo ishte organizuar nga Njësia për Mbështetje të Kuvendit në kuadër të Departamentit për qeverisje të mirë dhe institucione demokratike të Misionit të OSBE-së në Kosovë (OMiK). Objektivi i tryezës së rrumbullakët ishte që të ofrohej një forum për zgjerimin e dialogut mbi implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (LKD), dhe për të ngritur vetëdijesimin në mesin e bartësve të ndryshëm për implementimin e tij: Anëtarët e Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit e Qeverisë, Zyra e Ombudspersonit, OJQ-të, bota akademike, UNMIK-u dhe OSBE-ja. Në panelin e parë u diskutua për temën “Rëndësia e Ligjit mbi Kundër Diskriminimin për të Ardhmen e Kosovës”, ndërsa në panelin e dytë u diskutua për “Rolin e Shoqërisë Civile në Implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit”. Temat kryesore të diskutimit kanë qenë të drejtat sipas ligjit, problemet në implementimin e LKD-së, dhe roli i institucioneve publike dhe i shoqërisë civile në procesin e implementimit.

2. Fjala hyrëse

Ambasadori Werner Wnendt, Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Ambasadori Werner Wnendt, në fjalën e tij hyrëse, shtroi rëndësinë e ekzistencës dhe implementimit të LKD-së në Kosovë. Ai theksoi se LKD-ja, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, është njëri nga ligjet më përparimtare kundër diskriminimit në Evropë, ndërsa institucionet qeveritare kanë nevojë të shtojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që kërkesat sipas LKD-së të vihen në praktikë në mënyrë efektive.

Ambasadori shtoi se duhet të njihen dhe pranohen përpjekjet e Qeverisë dhe të Kuvendit për hapat që ato kanë ndërmarrë për krijimin e një Kosovë më të drejtë dhe më të barabartë; LKD-ja i ka forcuar parimet kundër diskriminimit që janë në fuqi në Kosovë, duke i bërë ato në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. LKD-ja promovon njëtrajtshmëri në gjykimin e formave të llojllojshme të diskriminimit, përfshirë diskriminimin në punësim dhe në qasje në shërbimet qenësore. Ndër të tjera, ajo ofron mjete gjyqësore dhe administrative efektive për viktimat e cilësdo formë të diskriminimit, si në sektorin publik, ashtu edhe atë privat.

Ambasadori Wnendt vuri në dukje se LKD-ja dhe implementimi i saj është me rëndësi të madhe duke pasur parasysh sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet Kosova. Implementimi i efektshëm i LKD-së mund të kontribuojë në realizimin e obligimeve të përshkruara me nenin 2(2.3) të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin, të paraqitur nga i Dërguari i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Kosovën, Marti Ahtisaari. Implementimi i LKD-së po ashtu paraqet harmonizim të mëtejshëm të legjislacionit brendshëm me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Ai theksoi se Ligji Kundër Diskriminimit është njëri nga shembujt e mirë të bashkëpunimit të frytshëm ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare. OSBE-ja, përmes përfaqësuesve të Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, ka ndihmuar në hartimin e ligjit, dhe po ashtu

¹²⁵ Remzije Istrefi është Këshilltare Bashkëpunëtoreshë Vendore e Njësisë për Qeverisje të Mirë në kuadër të Departamentit për Qeverisje të Mirë dhe Institucione Demokratike të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

ka mbështetur aktivisht implementimin e ligjit. Në dhjetor të vitit 2004, OSBE-ja ka mbajtur një seminar interaktiv me përfaqësues të Qeverisë, shoqërisë civile dhe ata të bashkësisë ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj seminari interaktiv doli një grup rekomandimesh që konsiderohen si udhëzime të përgjithshme për implementimin e LKD-së. Po ashtu, në vitin 2005, OSBE-ja e ka përkrahur hartimin e Planit Gjithëpërfshirës të Veprimit për Implementim të Ligjit Kundër Diskriminimit dhe me krijimin e njësisë për të drejta të njeriut në kuadër të secilës ministri, OSBE-ja i ka vendosur këshilltarët e lartë në këto njësi për të drejta të njeriut. Krahas këtyre iniciativave, OSBE-ja ka përkrahur edhe Institutin Gjyqësor të Kosovës në trajnimin e gjykatësve dhe të juristëve.

Ambasadori Wnendt përmbylli fjalën e tij duke thënë se Misioni është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë jetike të LKD-së në Kosovë, dhe si rrjedhojë e përtëriu premtimin e tij për të përkrahur plotësisht institucionet e Kosovës në procesin e vështirë të implementimit të LKD-së.

3. Paneli I: Rëndësia e Ligjit Kundër Diskriminimit për të ardhmen e Kosovës

Në këtë seancë, u diskutua roli i Institucionit të Ombudspersonit në implementimin e LKD-së, si dhe hapat e ndërmarrë nga Zyra e Kryeministrit për implementimin e këtij ligji. Në këtë seancë u përfshi edhe retrospektiva historike dhe antropologjike e konceptit të identitetit gjenetik dhe u fol rreth efektit të LKD-së në ndërtimin e identitetit në Kosovë. Në fund, u shqyrtua kontributi i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës në implementimin e LKD-së.

Z. Hilmi Jashari, Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit në Kosovë

Në prezantimin e tij, z. Jashari foli për rëndësinë e diversitetit dhe të mosdiskriminimit si elemente themelore të një shoqërie bashkëkohore. Ai vuri në dukje se LKD-ja e Kosovës është një hap drejt krijimit të kornizës ligjore për luftimin e diskriminimit në të gjitha sferat e jetës publike, dhe drejt dhënies fund të fenomenit të trajtimit të pabarabartë të individëve.

Z. Jashari theksoi se roli i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë (OIK) është komplementar sa i përket implementimit të LKD-së nga gjykatat. Roli i OIK-ut si mekanizëm për mbrojtje nga diskriminimi ka përparësitë e veta kur krahasohet me procedurën gjyqësore. Institucioni i Ombudspersonit shërben si ndërmjetësues midis autoriteteve publike dhe qytetarëve, ndërsa procedurat e tij janë më pak formale dhe më të shpejta kur krahasohen me një dëgjim në gjykatë, duke shtuar këtu shërbimet që ofrohen pa pagesë. Një përparësi tjetër është se IOK-u mund të hapë hetime *ex officio*, nëse ka informata nga burime të ndryshme se mund të ketë ndodhur një shkelje. OIK-u ka të drejtë, që në përputhje me juridiksionin e vet, t'u japë këshilla dhe rekomandime autoriteteve publike, por nuk mund të imponojë zbatimin e tyre.

Z. Jashari i informoi pjesëmarrësit se OIK-ut ka ndërmarrë veprime dhe ka hetuar pohimet në lidhje me praktikat diskriminuuese nga autoritetet publike dhe e ka publikuar raporte mbi diskriminimin që lidhen me çështjet si gjinia, moshja dhe punësimi. I ashtuquajtur "Ekipi Kundër Diskriminimit" (EKD) që krijuar në kuadër të Departamentit të Hetimeve të OIK-ut në mars të vitit 2004. Juristët që kanë punuar në këtë ekip, gjersa kanë punuar në ankesat tjera të dorëzuara në OIK, janë përqendruar në mënyrë të posaçme në rastet ku përfshihen të gjitha format e diskriminimit, përveç atyre ku përfshihet diskriminimi gjinor që trajtohet nga një Njësi e veçantë për Barazi Gjinore në kuadër të Departamentit të Hetimeve. Zëvendës drejtori i Departamentit të Hetimeve të OIK-ut e koordinon ekipin, krahas ekipeve të tjera të posaçme në Departamentin e Hetimeve. Sipas z. Jashari, EKD-ja në masë të madhe përpjket t'i koordinojë përpjekjet me autoritetet publike në zgjidhjen e ankesave të tilla, por fatkeqësisht, përgjigjja nuk ka qenë gjithmonë pozitive.

Në përmbyllje të fjalës së tij, z. Jashari vuri në dukje se vetëdijësimi në kuadër të shoqërisë së Kosovës

për parimin e diskriminimit dhe luftës kundër tij ende është i dobët. Të gjitha raportet mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, e veçanërisht të atyre të ashtuquajtura grupe të 'cenueshme' të njerëzve siç janë komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, etj., flasin për marginalizimin e këtyre kategorive të njerëzve, duke konfirmuar me këtë praninë e praktikave diskriminuese në të gjitha sferat e jetës publike. Sipas pikëpamjes së z. Jashari, kjo është arsyeja se pse shpallja e LKD-së së Kosovës në vitin 2004 ka qenë aq e rëndësishme, si masë kryesore në luftimin e të gjitha formave të diskriminimit.

Z. Habit Hajredini, Kryesues i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM)

Në prezantimin e tij z. Hajredini diskutoi për rëndësinë e shpalljes së LKD-së dhe vuri në pah se Qeveria e Kosovës, duke u mbështetur në nenin 12 (12.3) të LKD-së, është në procesin e miratimit të legjislacionit dytësor për të mundësuar implementimin e saj. Në vitin 2005, Qeveria e Kosovës e miratoi Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për Implementimin e LKD-së. Përveç kësaj, ajo miratoi Udhëzimin Administrativ nr. 04/2006, që parasheh krijimin e mekanizmave institucionalë për implementimin e LKD-së dhe themelimin e zyrave të pritjes (zyrat për ankesa dhe kërkesa). Këto zyra janë themeluar në kuadër të institucioneve qendrore dhe lokale dhe krijojnë mundësi që qytetarët të kenë kontakte të drejtpërdrejta me institucionet e Kosovës dhe të parashtrojnë ankesa, kur kjo është e nevojshme.

Më tej, z. Hajredini tha se legjislacioni në Kosovë përfshin të gjitha standardet kryesore të të drejtave të njeriut, por që implementimi i tyre është treguar të jetë i vështirë. Prandaj, kërkohen më shumë aktivitete dhe angazhim i shtuar për implementimin e të gjitha standardeve të të drejtave të njeriut, përfshirë parimin e mosdiskriminimit, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Z. Hajredini vuri në dukje se ZQM-ja e ZKM-së ka ndërmarrë një numër aktiviteteve si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal për të përmirësuar procesin e implementimit të legjislacionit, si dhe për t'i zvogëluar dhe përfundimisht për t'i eliminuar rastet e diskriminimit. Prioritet i ZQM-së të ZKM-së ka qenë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të lartë në nivelin qendror, si dhe të kapaciteteve të zyrtarëve të lartë komunal të cilët ose kanë ndikim, ose luajnë një rol domethënës në krijimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo në veçanti do të kishte rëndësi për krijimin e mundësive të barabarta dhe për zvogëlimin e numrit të rasteve të diskriminimit gjatë ushtrimit të obligimeve të tyre ligjore.

Z. Hajredini në vazhdim tha se menjëherë pas shpalljes së LKD-së, ZQM-ja e ZKM-së ka filluar fushatën për informim publik mbi LKD-në në promovimin me moto "Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë para ligjit", me qëllim të ngritjes së vetëdijes për LKD-në dhe për të drejtat që ky ligj i garanton. Gjatë fushatës, të gjitha informatat janë transmetuar në pesë gjuhë: shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe rome. Po ashtu, ZQM-ja ka krijuar një grup punues në të cilin përfaqësohen ZQM-ja, OSBE-ja, Zyra e Komisarit të Lartë për Pakicat Kombëtare (ZKLPK), Departamenti i Drejtësisë, Zyra për Komunitete, Kthim dhe Çështje të Pakicave dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, të cilit i është dhënë mandati për të hartuar Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për Implementimin e LKD-së. Drafti i planit është vënë në diskutim publik, në shtator të vitit 2005 dhe më pas është miratuar. Plani i Veprimit ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit, rritjen e barazisë efektive dhe realizimin e trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Gjithashtu, Plani i Veprimit përmban objektivat, parashton parametrat e aktiviteteve, afatet kohore dhe akterët që nevojiten për arritjen e këtyre objektivave, si dhe buxhetin e përafërt të propozuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorët e mundshëm. Fushata për ngritjen e vetëdijes, e cila është zhvilluar nga Departamenti i Administratës Qendrore (Ministria e Shërbimeve Publike), ka përfshirë shpërndarjen e materialit, afisheve dhe broshurave në të pesë gjuhët. Ky material është shpërndarë në të gjitha institucionet e Kosovës në divizionet dhe departamentet qendrore dhe lokale nëpër ministri dhe komuna.

Dr. Melissa Stone DQMID, Koordinatore e Njesisë për Qeverisje të Mirë pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë

Në prezantimin e saj, Dr. Stone elaboroi më tej rëndësinë e LKD-së. Në veçanti, ajo trajtoi çështjen se si LKD-ja është e rëndësishme. Dr. Stone theksoi se diskriminimi është çështje e jetës dhe vdekjes, jo vetëm në Kosovë, por në mbarë botën. Gjatë shekullit të kaluar, luftërat në bazë të ndarjeve mes popujve kanë shkaktuar më shumë lëndime dhe vdekje të parakohshme se sa malaria, tuberkulozi dhe HIV/SIDA së bashku. Do të ishte e lehtë të shihet se si këto ndarje mes popujve që shpesh shpjen në luftë, janë bazuar në konstruksione të identitetit.

Dr. Stone në vazhdim tha se në Kosovë, LKD-ja në thelb ridefinon identitetin. Sipas nenit 2 të LKD-së. “parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të ... përkatësisë etnike, kombit ... lindjes ose statuseve tjera”. Nëse shikohet më thellësisht, përkatësia etnike nënkupton trashëgiminë kulturore të personit dhe ndoshta origjinën e tij/saj gjenetike; kurse kombi shpesh nënkupton lidhjen me hapësirën gjeografike, me një vend të veçantë ose shtet kombëtar.

Dr. Stone vazhdoi duke vënë në pah faktin se, megjithatë, vetëm para rreth tetë viteve në Kosovë ka pasur përkufizime të ndryshme të etnisë, kombit dhe statusit të lindjes. Varësisht nga kombinimi i këtyre faktorëve, njerëz me identitete të ndryshme kanë pasur privilegje dhe përparësi të ndryshme. Më tej, ka qenë e zakonshme që fëmija në Kosovë automatikisht të trashëgojë etninë e babait të tij/saj. Kjo ka nënkuptuar që derisa LKD-ja ka hyrë në zbatim, nga aspekti kulturor në Kosovë ka qenë e pranueshme që fëmijët të mohojnë gjysmën e identitetit të tyre, për të zhvlerësuar përbërjen e tyre gjenetike amënore. Ndonëse injorimi i gjysmës së identitetit të një personi mund të ketë qenë politikisht e përshtatshme për ruajtjen e fantazisë për pastërtinë etnike, kjo nuk ka qenë e saktë për përcaktimin e identitetit gjenetik të kujtdoqoftë.

Dr. Stone përmendi se shkencat moderne rithekson nevojën për rishikimin e bazave biologjike dhe perceptimet e njerëzve për ndërlidhjen ndërmjet etnisë ose trashëgimisë kulturore; dhe kombit i cili e lidhë një person me një vend të veçantë. Projekti i kryer kohëve të fundit mbi Gjenet Njerëzore ka treguar se njerëzit e parë kanë qenë me origjinë nga Afrika, nga një vend që duket se është Gana rreth 150,000 vjet më parë, si dhe ka treguar një migrim masiv për në Lindjen e Mesme rreth 75,000 vjet më parë. Migrime pasuese kanë ndodhur para 50,000 vitesh nga Lindja e Mesme në Evropë dhe Azi. Më vonë, para rreth 20,000 vitesh kishte ndodhur migrimi masiv nga Azia në Amerikë.

Dr. Stone theksoi se nga e gjithë kjo mund të thuhet se informatat e reja shkencore mbi ndërlidhjen ndërmjet identitetit kulturor dhe atij gjenetik kërkojnë nga ne që të vëmë në pyetje konstruksionet tona të mëhershme për identitetin. Për shembull, ndoshta disa njerëz sot do të thoshin se janë shqiptarë të Kosovës. Por cila ka qenë trashëgimia e tyre gjenetike para kësaj? A kanë qenë ilir para 3,000 vitesh? Çka para kësaj? Kush kanë qenë ata?

Dr. Stone shtoi se shpreson që në procesin e implementimit të LKD-së do të shtrohen më shumë pyetje se sa përgjigje. Pyetjet janë të rëndësishme, pasi që sipas mendimit të saj do të shpjen në thellimin e diskutit publik dhe hapjen e një vizioni të ri për atë se sa të ndryshëm jemi njëri nga tjetri dhe sa të njëjtë jemi njëri me tjetrin. Sipas Dr. Stone, janë pyetjet, e jo përgjigjet e gatshme ato që shpjen në rrugën e kuptimit të asaj se si çdo person, pasi që është i të njëjtës origjinë si të gjithë të tjerët, meriton të ketë të njëjtat të drejta të njeriut.

Dr. Stone bëri të ditur se me qëllim të krijimit të një hapësire të lirë për të ecur përpara nga ky diskutim

publik për identitetin, ZQM-ja e ZKM-së, së bashku me ministrinë, OSBE-në dhe shumë akterë ndërkombëtar dhe lokal në këtë vit do të bashkësporojnë një fushatë të informimit publik për Ligjin Kundër Diskriminimit si vazhdimësi e fushatës që ka filluar dy vite më parë.

Z. Lavdim Krasniqi, Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK)

Z. Krasniqi foli për rolin e IGJK-së si një organ i pavarur profesional dhe institucion trajnimi në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës. Ai vuri në dukje se mandati kryesor i IGJK-së është trajnimi i gjykatësve dhe prokurorëve në aplikimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, fushat civile dhe penale, kundërvajtjet, etikën dhe trajnimin e gjyqtarëve laik. Qëllimi i IGJK-së është të rrisë profesionalizmin e gjykatësve dhe prokurorëve duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e punës së tyre. Llojet e trajnimeve që ofrohen në IGJK kanë formën e seminareve, punëtorive, simulimeve të seancave gjyqësore dhe konferencave. Që nga krijimi i saj, IGJK-ja ka trajnuar 4,792 gjykatës dhe 983 prokurorë. Gjithashtu, IGJK-ja publikon buletine mujore dhe materiale të ndryshme në të tri gjuhët zyrtare. IGJK-ja tanimë ka përgatitur dhe ka planifikuar trajnime për gjykatës dhe prokurorë mbi implementimin e LKD-së. IGJK-ja planifikon që të zhvillojë këto trajnime në muajt qershor dhe tetor të vitit 2007.

Në përmbyllje z. Krasniqi theksoi se ka mungesë të buxhetit për IGJK-në dhe kjo paraqet një pengesë për vazhdimin e aktiviteteve të IGJK-së përkitazi me implementimin e LKD-së.

Diskutim

Pas diskutimit të panelistëve, pjesëmarrësit u angazhuan aktivisht në një diskutim i cili u përqendrua në këto pika: rëndësinë e shpalljes dhe implementimit të LKD-së, hapat e ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës që nga shpallja e tij, arsytet pse LKD-ja nuk po implementohet, si dhe pengesat aktuale dhe hapat që duhet ndërmarrë nga faktorët relevantë në mënyrë që të arrihet implementimi i saj. Pjesëmarrësit kanë treguar interesim të madh për të marrë më shumë informata mbi fushatën për ngritjen e vetëdijes përkitazi me implementimin e LKD-së, si dhe shpjegime se si IOK-u i ka trajtuar rastet më të fundit. Pjesëmarrësit u pajtuan se në përgjithësi ka mungesë të informatave brenda shoqërisë së Kosovës lidhur me ekzistimin e LKD-së dhe që sundimi i ligjit duhet të funksionojë në mënyrë efektive, dhe kështu, Qeveria e Kosovës duhet të krijojë mekanizma më të mirë për implementimin e LKD-së. Për më tepër, gjykatësit dhe prokurorët nëpër gjykata nuk janë të informuar për ekzistimin e ligjit dhe për aplikimin e tij. Shumë nga pjesëmarrësit vunë në dukje se diskriminimi është i pranishëm si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik (p.sh. kushtet e vështira të punës për të rinjtë). Disa anëtarë të Kuvendit theksuan se të drejtat që përfshihen në LKD janë paraparë për të gjithë Kosovarët, prandaj, diskriminimi pozitiv i disa komuniteteve të veçanta i kundërvihet implementimit efektiv të LKD-së. Por, në fund, të gjithë theksuan se për të implementuar LKD-në, duhet të angazhohen plotësisht të gjithë faktorët relevantë.

4. Paneli II: Roli i shoqërisë civile në implementimin e Ligjit kundër Diskriminimit

Në seancën mbi rolin e shoqërisë civile në implementimin e Ligjit kundër Diskriminimit u hulumtuan praktikat më të mira në implementimin e ligjit të ngjashëm në Bullgari dhe diskriminimet që mund të ngjajnë në Kosovë nga perspektiva gjinore. Një përfaqësues i komunitetit serb të Kosovës ka avokuar masat e politikave të qeverisë për një implementim më efektiv të ligjit, ndërsa përfaqësuesi nga komuniteti RAE inicioi diskutimin nga këndvështrimi i komunitetit pakicë jo serbë.

Znj. Polina Roussinova, Konsulent ligjor për Komitetin e Helsinkit në Bullgari

Në prezantimin e saj, znj. Roussinova diskutoi për rolin e OJQ-ve në implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit dhe shkëmbeu përvojat e saj dhe praktikat më të mira nga Bullgaria. Znj. Roussinova foli mbi atë se çfarë konkretisht mund të bëjnë OJQ-të për të drejtat e njeriut, cilat veprime duhet ndërmarrë dhe cilat masa ekzistojnë për të siguruar implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Ajo në vijim sqaron veprimet/hapat që janë treguar të suksesshëm në këtë aspekt në Bullgari.

Kontestet gjyqësore strategjike: sjellja e rasteve strategjike të cilat ilustrojnë problemet strukturore apo plotësisht të shtrira të cilat ndikojnë tek një numër i madh individësh në shoqëri. Këto raste shkojnë përtej gjendjes së menjëhershme dhe të qenit individuale dhe mund të shërbejnë si mekanizma të rëndësishëm dhe efikas që çojnë në ndryshim shoqëror me efekt afatgjatë, ndryshime në pikëpamjet e opinionit publik dhe ndryshim në praktikën qeveritare. Këto raste strategjike mund të 'zbulohen' nga OJQ-të përmes një llojllojshmërie të kanaleve siç janë zyrat e hapura apo linjat telefonike për dhënien e ndihmës, vizitat në terren të OJQ-ve, nga sindikatat dhe situata tjera relevante. OJQ-të mund të sjellin lëndë të **kontesteve gjyqësore të orientuara drejt klientit** që përqendrohen vetëm në klientin dhe gjendjen e tij/saj. Rëndësia e këtij veprimi është se këto lëndë mund të shërbejnë si pika referuese për raste që paraqiten si të ngjashme në të ardhmen. Znj. Roussinova gjithashtu ka sqaruar që OJQ-të mund të involvohen në konteste gjyqësore strategjike përmes ndihmës ligjore (përfaqësimit të viktimës nga ana e OJQ-së), vetë-inicimit të lëndëve pa lejen e viktimës (*actio popularis*), dhe përmes *Amicus Curiae* (në emër të viktimës apo veprim grupor). OJQ-të mund të **studiojnë dhe monitorojnë** praktikatat e diskriminimit, të bëjnë raportime publike, lobim dhe avokim përmes mediave dhe të japin trajnime mbi LKD-në. Roli i mediave në lëndët kundër diskriminimit është shumë specifik; mediat duhet të përpiqen dhe të mbulojnë tërë procesin e rastit prej fazës fillestare deri në përfundimin e tij për të provokuar interesimin e opinionit publik dhe debatin. Në lëndët kundër diskriminimit, probabiliteti i suksesit nuk është më i rëndësishmi, por më parë debati të cilin e inicion, i cili lehtëson ndryshimin e mundshëm social. Ndonëse këto raste mund të mos jenë të suksesshme në nivel vendor, ekziston mundësia që ato të ngritën në nivelin ndërkombëtar si p.sh para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në përmbylljen e saj, znj. Roussinova informoi pjesëmarrësit që Komisioni i Helsinkit në Bullgari publikon raportin vjetor i cili i shpërndahet institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare. Znj. Roussinova i dëshiroi çdo të mirë shoqërisë Kosovare duke shprehur që përvoja e saj nga Bullgaria të shërbejë si mekanizëm i rëndësishëm në procesin e implementimit të Ligjit kundër Diskriminimit.

Znj. Arjeta Rexhaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën për studime dhe trajnime gjinore si dhe anëtare e Rrjetit të grave në Kosovë

Znj. Rexhaj ka theksuar se derisa ligji është pjesë e rëndësishme e legjislacionit, mbetet shumë për t'u bërë për ta implementuar atë. Implementimi i LKD-së varet nga bashkëpunimi mes IPVQ-ve, UNMIK-ut, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Kosova nuk ka nevojë vetëm të bëjë ligje por edhe t'i implementojë ato. Shoqëria Civile, në veçanti grupet e grave janë posaçërisht të interesuara në implementimin e LKD-së.

Znj. Rexhaj pohoi se për shkak të gjendjes së ndjeshme që kanë, gratë në Kosovë janë të diskriminuara në çdo aspekt të jetës. Gratë në Kosovë janë pothuajse të përjashtuara nga procesi i vendimmarrjes, dhe të drejtat e tyre shkelen jo vetëm nga institucionet publike por edhe në shtëpitë e tyre. Dhuna familjare mbetet akoma çështje shqetësuese. Prandaj, shpallja e LKD-së shihet si hap pozitiv në përmirësimin e pozitës së grave, meqë parasheh veprime afirmative për kompensimin e dëmeve viktimave të diskriminimit siç janë personat e hendikepuar, gratë dhe fëmijët. Palët relevantë të interesit në Kosovë duhet të angazhohen për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për të siguruar implementim të suksesshëm të LKD.

Znj. Rexhaj shtoi se Qendra për Studime dhe Trajnime Gjinore ka luajtur rol të rëndësishëm në arsimimin për të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes përmes organizimit të trajnimeve, ligjëratave, konferencave, tryezave të rumbullakëta dhe debateve për të drejtat e njeriut.

Në përmbylljen e saj, Znj. Rexhaj rekomandoi që shoqëria civile të angazhohet në procesin e përpilimit të legjislacionit dhe të involvohet më shumë në vetëdijesim.

Z. Nenad Rikalo, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së "Future"

Z. Rikalo tregoi se qenë skeptik për zhvillimin e tryezës së rrumbullakët ku do të diskutohej LKD-ja. Anti-diskriminimi është politizuar si çështje në Kosovë. Si përfaqësues dhe aktivist i shoqërisë civile brenda komunitetit serbë në Kosovës, ai theksoi se shoqëria civile është e pozicionuar dhe vepron në dimensione tjera dhe jo në politikë, prandaj shoqëria civile duhet të shprehë dhe të promovojë kapacitetet dhe vlerat e qytetarëve. Këto vlera, në veçanti parimi kundër diskriminimit, duhet të respektohen dhe të promovohen përmes marrëdhënieve konstruktive mes shoqërisë civile dhe institucioneve të qeverisë.

Sipas Z. Rikalo, ekzistojnë dy qasje kryesore të cilat duhet të ndërmerren nga shoqëria civile; qasja më kritike dhe krijimi i partneriteteve me institucionet e qeverisë. Tani është i dukshëm stereotipi për shoqërinë civile si një kritikues konstant, por tani është koha të fillohet me ndërtimin e partneriteteve me institucionet e qeverisë për të krijuar mundësi për implementimin e suksesshëm të LKD-së. Ekzistojnë katër mënyra ku shoqëria civile mund të luajë rol aktiv në implementimin e LKD-së:

- *Informimi*: është e qartë se ekziston një mungesë e informimit në mesin e popullatës së Kosovës mbi LKD-në, prandaj shoqëria civile këtu mund të luajë një rol shumë aktiv;
- *Promovimi*: ekzistojnë shumë mënyra për shoqërinë civile që të promovojë LKD-në dhe të gjitha aspektet e tij pozitive;
- *Prezantimet*: shoqëria civile dhe institucionet e qeverisë duhet të prezantojnë çfarë mund dhe çfarë duhet bërë; dhe
- *Presioni*: shoqëria civile duhet të ndërmarrë aktivitete të ndryshme për të shtuar presionin tek institucionet e qeverisë. Aktivitetet e tilla përfshijnë debatet, tryezat e rrumbullakëta dhe paraqitjen në media.

Në përmbylljen e tij, Z. Mr. Rikalo pohoi që e ka të qartë që implementimi i LKD nuk është i lehtë dhe se kërkon shumë përpjekje nga të gjithë akterët relevantë.

Z. Osman Osmani, Anëtar i rrjetit FORUM dhe Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së

'Iniciativa 6'

Z. Osmani foli për pozitën e vështirë të fëmijëve në Kosovë. Megjithatë, ai theksoi se pozita e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian është më e vështira. Fëmijët e komunitetit RAE në përgjithësi gjenden jashtë shkollave duke kërkuar lëmshë në rrugë dhe duke qenë të ekspozuar ndaj punës së vështirë. Ai theksoi se përderisa nuk dëshiron që çështja e fëmijëve të komunitetit RAE të politizohet, gjithsesi gjendja e komunitetit RAE mbetet më e vështira. Ai pohoi në vijim se ekzistojnë përpjekje nga IPVQ dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për të përmirësuar dhe ndihmuar kushtet e jetesës për komunitetin RAE në përgjithësi dhe fëmijët e këtij komuniteti në veçanti por sërish gjendja akoma mbetet e vështirë. Në përmbylljen e tij, Z. Osmani përshëndeti organizatorët dhe shprehi gatishmërinë e komunitetit të tij për të bashkëpunuar në përmirësimin e implementimit të LKD-së.

Diskutimi

Prezantimet e panelistëve kanë ngritur dukshëm nivelin e interesimit në mesin e pjesëmarrësve; përvoja bullgare ishte lavdëruar në veçanti dhe u rekomandua nga pjesëmarrësit si e përshtatshme edhe për Kosovën. Shumë pjesëmarrës theksuar sërish mungesën e njohurive për LKD në shoqërinë e Kosovës. Përfaqësuesit e komunitetit të OJQ-ve diskutuan mbi atë që autoritetet e Qeverisë duhet të japin jenë më të përgjegjshëm për dështimet për të informuar opinionin publik, ndërsa përfaqësuesit e OQM/ZKM theksuar që fushatat për rritjen e vetëdijes janë lansuar që nga maji 2004. Broshurat informative që kanë të bëjnë me LKD janë botuar dhe shpërndarë në pesë gjuhë që fliten në Kosovë: shqip, serbisht, boshnjakisht, turqisht dhe në gjuhën rome.

Diskutimi për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e përpilimit të ligjit gjithashtu ka shtuar debatet.

Ka pasur kritika nga OJQ-të e pranishme për mungesën e përfshirjes domethënëse dhe të pavarur, ndër-sa përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës thanë që OJQ-të rregullisht ftohen të marrin pjesë dhe komentet e tyre gjithmonë merren parasysh.

Të gjithë u pajtuan se implementimi i ligjeve në përgjithësi, dhe implementimi i LKD-së në veçanti ballafaqohen me shumë vështirësi. Përkundër faktit që implementimi i LKD-së është i ngadalshëm ai ka filluar të marrë formën e vet. Pjesëmarrësit edhe njëherë theksuan që institucionet e Qeverisë dhe shoqëria civile duhet të vazhdojnë punën në procesin e informimit të shoqërisë kosovare për ekzistimin e LKD-së.

LUFTIMI I DISKRIMINIMIT MBI BAZA TË ORIENTIMIT SEKSUAL

Qendra për Emancipim Shoqëror
www.qesh.org

Qendra për Emancipim Shoqëror (QESH) u themelua në prill të vitit 2005, me qëllim të promovimit të drejtave të njeriut të homoseksualëve (meshkuj dhe femra) biseksualëve dhe transgjinjorëve (LGBT). Që atëherë, janë zhvilluar veprimtari të ndryshme projektesh, me synimin e krijimit të një mjedisi të sigurt, tolerant dhe miqësor ndaj komunitetit LGBT në Kosovë, si dhe për ngritjen e vetëdijes së popullsisë së përgjithshme mbi të drejtat e individëve të komunitetit LGBT. Porosia që QESH-i po mundohet të dërgojë qysh prej fillimit të saj është që secili është i barabartë, pa marrë parasysh dallimet e tyre.

QESH-i konsideron Ligjin Kundër Diskriminimit si ligj shumë gjithëpërfshirës dhe mbrojtës, i cili mbron të drejtat e gjitha qenieve njerëzore, duke përfshirë komunitetin LGBT. Neni 2(a) i Ligjit Kundër Diskriminimit përmend në mënyrë të veçantë orientimin seksual si bazë e mundshme e diskriminimit, duke përfshirë kështu pakicat seksuale brenda parimit të trajtimit të barabartë.

Përkundër kornizës së përparuar ligjore, duhet theksuar që pakicat seksuale ende ballafaqohen me diskriminim dhe stigmatizim në shoqërinë kosovare, si dhe shpesh janë viktime të krimeve të urrejtjes.

Krimet e urrejtjes kundër personave të komunitetit LGBT shpesh mbesin të paraportuara, të padokumentuara dhe përfundimisht të padënuara, sepse pakicat seksuale shpesh nuk mund të raportojnë dhunën e kundër tyre. Ata frikësohen që orientimi i tyre seksual do të bëhet publik gjë që i bën ata ose familjet e tyre shënjestër të dhunës së mëtutjeshme. Ata frikësohen që ankesat e tyre nuk do të merren seriozisht ose që ankesat e tilla mund të përdoren si hakmarrje kundër tyre. Me arsye, atyre iu mungon besimi në autoritete të cilat janë të obliguara t'i mbrojnë.

Pasi krimet e urrejtjes dhe diskriminimi kundër komunitetit LGBT ndodhin rregullisht në Kosovë, QESH-i orvatet për zbatim të shëndoshë dhe korrekt të Ligjit Kundër Diskriminimit, në mënyrë që shkeljet e të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të dënohen sipas dispozitave.

Hollësitë e kontaktimit:
Tel: +377 (0)44 811 934
Email: qesh.kosovo@gmail.com
Faqja e internetit: www.qesh.org



OSCE
Mission in Kosovo

Office of the Prime-Minister, 10000, Prishtinë/Priština
Office of Good Governance, Director Habit Hajredini
Tel: (+381 - 38) 200 140 70 Fax (+381 - 38) 200 146 43
contact: habit.hajredini@ks-gov.net

OSCE Mission Headquarters
10000, Prishtinë/Priština
Tel: (+381 - 38) 500 162 Fax (+381 - 38) 240 711
contact: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/Kosovo>